



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
“Nanoteknologji”**

ofruar nga

Universiteti "Western Balkans"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Kledi Xhaxhiu

Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha

Tetor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në: “Nanoteknologji”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Western Balkans”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Nanoteknologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 461, datë 14.08.2023
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a. 2023 – 2024 – 6 PAE dhe 2 PAK v.a. 2024 – 2025 – 9 PAE dhe 4 PAK
18	Numri i studentëve:	Studentë të regjistruar për herë të parë: v.a. 2023 – 2024 – 7 studentë v.a. 2024 – 2025 – 4 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit *Master i Shkencave* në "Nanoteknologji" ofrohet nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë (DBI), i cili më parë njihej si Departamenti i Teknologjisë dhe Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI), pranë Universitetit "Western Balkans" (WBU). WBU është një institucion i arsimit të lartë jo publik, i themeluar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 679, datë 10.11.2021, "Për hapjen e Institucionit të Arsimit të Lartë jo publik Universiteti Western Balkans".

Hapja e programit të studimit të ciklit të dytë *Master i Shkencave* në "Nanoteknologji" është miratuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 461, datë 14.08.2023, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren themelore të tij.

Ky program realizohet me 120 kredite, në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë *Master i Shkencave* në "Nanoteknologji" në Fakultetin e Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, të Universitetit "Western Balkans", referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit i ciklit të dytë *Master i Shkencave* në "Nanoteknologji" është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2023 – 2024, ku janë regjistruar 7 studentë. Në vitin akademik 2024 – 2025, janë regjistruar 4 studentë, prej të cilëve edhe 1 student i huaj.

Programi është konceptuar për të përgatitur specialistë të kualifikuar në fushën e nanoteknologjisë, të aftë për të përballuar sfidat teknologjike bashkëkohore dhe për të kontribuar në zhvillimin shkencor dhe industrial. Metodologjia e mësimdhënies përfshin integrimin e teorisë me praktikën laboratorike, duke promovuar aftësi profesionale dhe kompetenca bashkëpunimi ndërdisiplinar.

Programi zhvillohet në bashkëpunim me Njësinë NanoAlb (Njësia Shqiptare e Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë), njësi pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila luan rol koordinues për aktivitetet në këtë fushë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof.Dr Kledi Xhaxhiu dhe Prof. Asoc. Genta Rexha, me mbështetjen e koordinatorit të ASCAL, MSc. Muhamed Prezja. Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin Mars 2025, me dorëzimin nga ana e Universitetit "Western Balkans" (WBU) të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës. Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me WBU, në datat 09 - 10 Prill 2025, GVJ vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh dhe intervistash me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit, Përgjegjësin e Departamentit të Bioshkencave dhe Inxhinierisë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Kërkimit Shkencor, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Zyrës së Planifikimit të Karrierës, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe me studentët e programit të studimit.

Gjithashtu, GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Bibliotekë, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.


Universiteti "Western Balkans" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 22.09.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24/34 prot, datë 22.09.2025. Universiteti "Western Balkans" përcjell në ASCAL më datë 02.10.2025, me anë të shkresës me Nr. 612 / 1 Prot, datë 29.09.2025 "Kthim përgjigje shkresës nr. 24/34 prot datë 22.09.2025", komentet mbi draft raportin. *Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

1. Në lidhje me sqarimin/komentin për konkluzionin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e standartit IV.1, Kriteri 1:

GVJ ka arritur në këtë konkluzion, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së vetëvlerësimit. Argumentimi i dhënë nga institucioni nuk e justifikon dhe as nuk mund të anashkalojë bazën ligjore ekzistuese. Vlerësojmë që konkluzioni të mbetet në RVJ. **Raporti nuk ndryshon.**

2. Në lidhje me sqarimin/komentin për konkluzionin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e standartit IV.3, Kriteri 2:

GVJ ka arritur në këtë konkluzion, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së vetëvlerësimit. Argumentimi i paraqitur nga institucioni mund të konsiderohet si pjesë e planit të masave të ardhshme. Vlerësojmë që konkluzioni të mbetet në RVJ. **Raporti nuk ndryshon.**



3. Në lidhje me sqarimin/komentin për konkluzionin e paraqitur në draft-RVJ, për përmbushjen e standartit VI.1, Kriteri 1:

GVJ ka arritur në këtë konkluzion, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të dosjes së vetvlerësimit. GVJ rekomandon që institucioni të vërë në dispozicion një dokument të shkruar për stafin akademik, i cili të shërbejë si udhërrëfyes praktik. Ky dokument duhet të synojë zhvillimin profesional të stafit në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke i nxitur të gjithë, pavarësisht formimit, moshës apo eksperiencës së mëparshme, të përvetësojnë dhe aplikojnë metoda të reja mësimdhënieje. Vlerësojmë që konkluzioni të mbetet në RVJ. **Raporti nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Nanoteknologji"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përputhje me Statutin e tij [<i>Statuti, Neni 3, fq. 2</i>], WBU ka mision formimin e profesionisteve të së ardhmes, të fokusuar në të mirë dhe në funksion të individit dhe shoqërisë, si edhe angazhohet për të qenë një universitet i spikatur ndërkombëtarisht në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, me qëllimin kryesor përmirësimin e vazhdueshëm të jetës. WBU synon të shndërrohet në një qendër ekselence në fushën e arsimit të lartë në vend, rajon dhe më gjerë, si në aspektin akademik, në atë të kujdesit shëndetësor, dhe në aspektin kërkimor dhe inovativ.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e WBU për të qenë një promotor i zhvillimit të shëndetësisë, ekonomisë dhe shoqërisë në vend, duke nxitur përparimin dhe inovacionin, duke promovuar përkujdesjen dhe ndërveprimin me qytetarët, sistemin ekonomik dhe institucionet publike dhe private në vend [<i>Statuti, Neni 3, fq. 2</i>].

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi i ri Master i Shkencave në “Nanoteknologji” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me planin strategjik 2023-2030 të Institucionit, “Rruga drejt ekselencës”, fusha 2: Ekselencia në edukim. WBU synon përmirësimin e profilit të tij akademik në Teknologji, Nanoteknologji, IT, AI, Shkenca të Informacionit Shëndetësor, etj, përmes programeve të reja ndërdisiplinore Bachelor dhe Master [Evidencë 1.2, fq. 22].			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i Studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe synimet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2020–2030, duke kontribuar në zhvillimin teknologjik dhe inovativ të vendit. Gjithashtu, programi është në linjë me prioritetet e Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit dhe inovacionit, veçanërisht në kuadër të Programit Horizon Europe, duke nxitur bashkëpunimin shkencor ndërkombëtar dhe përshtatjen me prirjet globale në fushën e nanoteknologjisë.			
Konkluzione	<i>Programi i Studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” ofrohet nga WBU, në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</i> <i>Programi është gjithashtu i harmonizuar me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe orientimet ndërkombëtare, duke reflektuar një qasje të integruar dhe bashkëkohore në edukim dhe kërkim shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në	Gjatë vitit akademik 2023 – 2024, Departamenti i Teknologjisë dhe Biznesit [Evidencë 1.5], si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI), përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” ka patur në

fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	përbërje të tij 9 personel akademik efektiv (PAE) me kualifikimin si më poshtë: - 1 Prof. Asoc. Dr; - 4 Dr; - 4 MSc; Si dhe dhe 4 personel akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin si më poshtë: - 2 Prof. Asoc; - 2 Dr; Gjatë vitit akademik 2024 – 2025, Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë (DBI) si strukturë e re përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” ka në përbërje të tij 8 personel akademik efektiv (PAE) me kualifikimin si më poshtë: - 1 Prof. Dr; - 5 Dr; - 2 MSc; Si dhe 8 personel akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin si më poshtë: - 1 Prof. Dr; - 1 Prof. Asoc; - 4 Dr; - 2 MSc; [Tabelat përmbledhëse, Tabela 2]. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij [CV stafi]. DBI disponon, në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” laboratorë bashkëkohore dhe marrëveshje me institucione brenda dhe jashtë vendit përmes të cilave, studentët realizojnë orët praktike në përputhje me programin e studimit dhe nevojat për aftësimin praktik të tyre [Evidencë 1.7, Evidencë 1.9].
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit,	Programi i studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” ofrohet nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë (DBI), si pjesë e e Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI), në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij [Evidencë 1.1, Neni 14]. Në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, kodi i programit të studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” është 72MS0719A:



sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	07 – Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtim (<i>Engineering, Manufacturing and Construction</i>), 071 - Inxhinieri dhe profesione inxhinierike (<i>Engineering and engineering trades</i>) dhe kodi 0719 - Inxhinieri dhe profesione inxhinierike të paklasifikuara diku tjetër: Nanoteknologjia (<i>Engineering and engineering trades not elsewhere classified: Nanotechnology</i>). Kodifikimi i lëndëve të programit është bërë duke konsideruar kodin e shkurtuar për programin e studimit NAN, ndjekur për çdo lëndë me vitin në të cilin zhvillohet lënda dhe rradhitjen e lëndës në kurrikul brenda vitit përkatës (tek për semestrin e parë dhe çift për semestrin e dytë), për shembull lënda “Hyrje në nanoshkencë dhe nanoteknologji”, kodi NAN 101: 1 - lëndë e vitit të parë, 01 - e radhitur e para në kurrikul brenda lëndëve të vitit të parë në semestrin e parë [<i>Evidencë 1.4</i>].
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” ofrohet nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë (DBI). DBI ofron gjithashtu edhe dy programe studimi, Bachelor në “Bioteknologji” dhe Bachelor në “Inxhinieri Biomjekësore” [https://wbu.edu.al/sq/departament/departament-of-biosciences-and-engineering]. Programet e ofruara nga DBI janë në përputhje me fushën e tij akademike dhe kërkimore.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilin të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N / A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nisur nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vizitat në institucion, GJV konstaton që WBU nuk ofron aktualisht trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. Brezi i parë i studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” pritet të diplomohet në Korrik 2025.

Konkluzione	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar dhe të gjetjeve të evidentuara, konstatohet se programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë dhe njësisë kryesore përgjegjëse. Institucioni dëshmon kapacitetet akademike, përvojën dhe infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e programit të studimit në fushën e nanoteknologjisë. Kodi i programit dhe struktura e tij janë në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe ndërkombëtare. GVJ konstaton se aktualisht nuk ofrohen trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar, pasi brezi i parë i studentëve pritet të diplomohen në Korrik 2025.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" realizohet nga DBI, mbështetur në statutin e Universitetit [Statuti], rregulloren themelore të Institucionit [Rregullore Institucionale], rregulloren e Fakultetit [Evidencë 1.1], si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik efektiv dhe personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësisë respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre [Statuti, Kreu III, fq. 38]. Marrëdhënia midis strukturave të ndryshme brenda WBU, njësive të ndryshme administrative dhe akademike rregullohet përmes rregullores themelore të Institucionit [Rregullore Institucionale] dhe rregulloreve të posatshme mbi organizimin akademik dhe organizimin administrativ të WBU [Evidencë 1.15, Evidencë 1.16].
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, WBU ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi

mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	me një sërë institucionesh homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët e biznesit vendas dhe të huaj <i>[Evidencë 1.9]</i>. Këto marrëveshje mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave të stafit dhe studentëve, zhvillimin e praktikave mësimore, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara <i>[Evidencë 2.17, Evidencë 2.33, Evidencë 3.21]</i>.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në kuadër të realizimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” një rol të veçantë zë bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me njësinë NanoAlb (sot NanoBalkans), bashkëpunim i cili ka qenë iniciues për propozimin e këtij programi të ri studimi <i>[Evidencë 1.3]</i>. Gjatë vizitës në Institucion, u vu theksi tek bashkëpunimi me Universitetin Epoka në kuadër të përdorimit të laboratoreve në fushën e nanoteknologjisë. Në lidhje me zhvillimin e praktikave mësimore, bashkëpunimi i WBU me ente të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare <i>[Evidencë 1.9]</i> mundëson realizimin e tyre me sukses. Gjatë vizitës, përgjegjësi i departamentit sqaroi se praktikat mësimore të parashikuara në kurrikul nuk zhvillohen në një institucion të vetëm; studentët kanë mundësinë të angazhohen në disa kompani dhe, përmes rotacionit, të kryejnë praktikat pranë tyre, duke përfutur përvoja të ndryshme përgjatë periudhës së praktikës. Aktualisht, dy studentë diplomantë po realizojnë punën e tyre të diplomës në Universitetin e Torinos, falë bashkëpunimit me grupet kërkimore të këtij universiteti.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Brezi i parë i studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” pritet të diplomohet në Korrik 2025. Praktikrat mësimore janë aktualisht në proces zhvillimi. <i>Rekomandohet që DBI të ketë në vëmendje hartimin e raporteve analitike mbi përfitimet e marra nga marrëveshjet kontraktuale, në funksion të realizimit sa më cilësor të programit të studimit.</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione akademike dhe kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të biznesit. Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe përdorimi i infrastrukturës në dispozicion të partnerëve</i>

	<i>mbështesin zhvillimin e praktikave mësimore dhe mobilitetin e studentëve dhe stafit.</i> <i>GVJ, duke qenë se brezi i parë i studentëve pritet të diplomohet në Korrik 2025 dhe praktikat mësimore janë ende në proces, rekomandon që njësia përgjegjëse të hartojë në vijim raporte analitike periodike mbi efektivitetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Nanoteknologji”, i ofruar nga DBI pranë WBU, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit ka 120 ECTS me 60 ECTS cdo vit. <i>[Evidencë 1.4]</i> .
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale	Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Nanoteknologji” synon të formojë studentët me shprehje të veçanta, duke u ofruar atyre mundësinë të zhvillojnë një larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh në fushën e nanoteknologjisë

e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	dhe disiplinave të lidhura me të. Ky program garanton përvetësimin e njohurive të avancuara dhe një formim cilësor e inovativ, duke përfshirë të kuptuarit kritik të teorive, parimeve akademike dhe teknologjive që karakterizojnë këtë fushë të re dhe dinamike. Përmes procesit mësimor dhe kërkimor, programi zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të thelluara akademike dhe profesionale, të cilat janë të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e nanoteknologjisë. Programi inkurajon angazhimin e studentëve në projekte kërkimore dhe bashkëpunime ndërkombëtare, duke promovuar lidhjen midis kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik. Studentët përfitojnë mundësi për të zhvilluar praktika profesionale në laboratorë të avancuar, duke krijuar lidhje të ngushta mes teorisë dhe praktikës. Përmes përfshirjes aktive në projekte kërkimore dhe bashkëpunimeve me institucione akademike dhe industri vendase e ndërkombëtare, diploma i pajis studentët me aftësi analitike dhe inovative. Kështu, ata përgatiten të marrin role të rëndësishme në mjedise akademike, kërkimore ose industriale, duke u bërë profesionistë të aftë në fushën e nanoteknologjisë.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Si pjesë e lëndëve plotësuese (D) është parashikuar lënda “Praktikë profesionale”, gjithsej 12 ECTS. Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë “Temë diplome”, gjithsej 14 ECTS [<i>Evidencë 1.4</i>].
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A

Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N / A
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në Republikën e Shqipërisë nuk ofrohen programe të tjera të ngjashme me programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Nanoteknologji” të ofruar nga WBU.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, kodi i programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Nanoteknologji” është 72MS0719A: 07 – Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtim (<i>Engineering, Manufacturing and Construction</i>), 071 - Inxhinieri dhe profesione inxhinierike (<i>Engineering and engineering trades</i>) dhe kodi 0719 - Inxhinieri dhe profesione inxhinierike të paklasifikuara diku tjetër: Nanoteknologjia (<i>Engineering and</i>



	<i>engineering trades not elsewhere classified: Nanotechnology).</i> Kodifikimi i lëndëve të programit është bërë duke konsideruar kodin e shkurtuar për programin e studimit NAN, ndjekur për çdo lëndë me vitin në të cilin zhvillohet lënda dhe rradhitjen e lëndës në kurrikul brenda vitit përkatës (tek për semestrin e parë dhe çift për semestrin e dytë), për shembull lënda “Hyrje në nanoshkencë dhe nanoteknologji”, kodi NAN 101: 1 - lëndë e vitit të parë, 01 - e radhitur e para në kurrikul brenda lëndëve të vitit të parë në semestrin e parë [<i>Evidencë 1.4</i>].			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky program studimi ofrohet nga WBU pa bashkëpunim me institucione të tjera.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është i organizuar dhe i strukturuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofron një formim të avancuar akademik dhe profesional, duke zhvilluar aftësi dhe kompetenca të thelluara për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e nanoteknologjisë.</i> <i>Programi ka përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për praktikat profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, si dhe është kodifikuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet akademike. Ky program studimi nuk ofrohet në bashkëpunim me Institucione të tjera.</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI) përbëhet nga 3 Departamente dhe 1 Qendër Kërkimore: 1. Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë; 2. Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe Financës; 3. Departamenti i Shkencave Kompjuterike; 4. Qendra Kërkimore- Shkencore SMTI; Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI) për vitin akademik 2024-2025 ka gjithsej 47 pedagogë, nga të cilët 31 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 16 pedagogë me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th colspan="3">Personeli akademik pranë Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit</th></tr><tr><th>Grada/titulli</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>2</td><td>2</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr.</td><td>17</td><td>7</td></tr><tr><td>Msc</td><td>9</td><td>5</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>31</td><td>16</td></tr></table> Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë (DBI) për dy vite akademike ka përbërjen si më poshtë vijon: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>1</td><td>2</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>4</td><td>2</td><td>5</td><td>4</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>4</td><td>-</td><td>2</td><td>2</td></tr><tr><td>Totali</td><td>9</td><td>4</td><td>8</td><td>8</td></tr></table> [Tabelat përmbledhëse, Tabela 2]	Personeli akademik pranë Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit			Grada/titulli	PAE	PAK	Prof.Dr	2	2	Prof.Asoc.	3	2	Dr.	17	7	Msc	9	5	Gjithsej	31	16	Tituj/ grada	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	1	1	Prof. Asoc.	1	2	-	1	Dr./PhD.	4	2	5	4	Msc.	4	-	2	2	Totali	9	4	8	8
Personeli akademik pranë Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit																																																								
Grada/titulli	PAE	PAK																																																						
Prof.Dr	2	2																																																						
Prof.Asoc.	3	2																																																						
Dr.	17	7																																																						
Msc	9	5																																																						
Gjithsej	31	16																																																						
Tituj/ grada	2023-2024		2024-2025																																																					
	PAE	PAK	PAE	PAK																																																				
Prof.Dr.	-	-	1	1																																																				
Prof. Asoc.	1	2	-	1																																																				
Dr./PhD.	4	2	5	4																																																				
Msc.	4	-	2	2																																																				
Totali	9	4	8	8																																																				
kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke	Në programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Nanoteknologji”, gjatë vitit akademik 2023 – 2024 janë angazhur në mësimdhënie 6 PAE (3 Prof. Asoc. Dr., 2 Dr., 1 Msc.), 2 PAK (2 Dr.), ndërsa gjatë vitit akademik 2024 – 2025, janë angazhuar 9 PAE (1 Prof. Dr, 1 Prof. Asoc. Dr., 5 Dr., 2 Msc.), 4 PAK (2 Dr., 1 Msc.). Gjithashtu, pranë DBI janë																																																							

angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	angazhuar edhe 3 personel ndihmës akademik me karakter mësimor [Tabelat përmbledhëse, Tabela 6, Evidencë 2.4].			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Koordinatori për programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në "Nanoteknologji" është Prof. Asoc. Dr. E. S. [Evidencë 2.5]. Koordinator i programit është përgjegjës për ecurinë, zhvillimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe praktikave profesionale, duke përfshirë zhvillimin, zbatimin, vlerësimin dhe shtrirjen e kurrikulës, në përputhje me objektivat e tij. Përveç koordinatorit, çdo departament cakton një anëtar të stafit akademik me kohë të plotë si këshilltar akademik për çdo grup studentësh [Rregullore Institucionale, Neni 60]. Këshilltari ndjek dhe udhëzon studentin mbi anën akademike, progresin dhe performancën e tij gjatë periudhës së studimeve. Këshilltari akademik miraton formularët e regjistrimit semestral të lëndëve për çdo student përkatës.			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë.</i> <i>Koordinatori i programit dhe këshilltarët akademikë ushtrojnë funksionet në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të WBU, duke mbështetur zhvillimin e programit dhe ndihmuar studentët në rrugëtimin e tyre akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për	Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë (DBI), pranë Fakultetit të Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit (FETI). DBI disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me Statutin [Statuti], rregulloren

organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	themelore të Universitetit [<i>Rregullore Institucionale</i>] dhe rregulloren e fakultetit [<i>Evidencë 1.1</i>].
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në planin mësimor [<i>Evidencë 1.4</i>] të programit të studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” jepet informacioni i detajuar për ndarjen e lëndëve në semestra dhe ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues, p.sh. lënda “Hyrje në Nanoshkencë dhe Nanoteknologji” e kategorisë A, gjithsej 6 ECTS, është e organizuar në 30 orë leksione, 15 orë seminare, 15 orë laboratore dhe 90 orë punë individuale). Gjatë vitit të parë, janë parashikuar 5 lëndë për secilin semestër, gjithsej 60 ECTS, të shpërndara në mënyrë të barabartë përgjatë dy semestrave. Gjatë vitit të dytë, në semestrin e parë janë parashikuar 5 lëndë, gjithsej 30 ECTS, dhe në semestrin e dytë janë parashikuar 1 lëndë me zgjedhje, praktika profesionale dhe tema e diplomës, gjithsej 30 ECTS [<i>Evidencë 1.4</i>].
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren themelore të Universitetit [<i>Rregullore Institucionale, Kreu X, Neni 55, pika 2</i>] jepen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit të studentëve. Pranohen për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, shtetasit shqiptarë ose të huaj që kanë përfunduar një program studimi dhe që plotësojnë këto kushte: a. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e programit të studimit të ciklit të parë në Shqipëri ose jashtë shtetit dhe/ose vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një institucion publik ose privat i arsimit të lartë që ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri ose jashtë shtetit; b. Studentët që kanë përfunduar studimet jashtë shtetit, duhet të paraqesin ekuivalentimin; c. diplomë universitare përkatëse; d. Pranojnë pagesën e tarifës së caktuar vjetore; Për shtetasit e huaj kërkohen edhe dokumentet e parashikuara në paragrafin e dytë të pikës 1 të mësipërme. Të gjithë shtetasit që regjistrohen pranë Universitetit “Western Balkans” duhet të plotësojnë çdo kriter tjetër të përcaktuar në bazë të udhëzimeve të Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin. Në rregulloren për njohjen dhe transferimin e studimeve jepen

	kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve <i>[Evidencë 5.9, Neni 3]</i>: 1. Universiteti Western Balkans ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, të kryera brenda institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë; 2. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm; 3. Njohja kryhet nga njësia bazë përkatëse, pranë të cilës është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve; 4. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Nuk mund të kryhen transferime studimesh nga një nivel cikli studimesh apo të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në një tjetër. Në këtë kuadër nuk mund të kryhen transferime studimesh nga programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional në programe të ciklit të parë "Bachelor" dhe në programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave".
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset e detajuara të çdo lënde <i>[Syllabuse]</i>, hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" <i>[Evidencë 1.4]</i>, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore dhe ngarkesën përkatëse brenda auditorit. <i>Në syllabuset e lëndëve nuk është specifikuar ngarkesa jashtë auditorit.</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet	Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është një program i ri studimi dhe nuk i është nështruar ndryshimeve në kurrikul. Institucioni në aktet e tij rregullatore parashikon rishikimin e kurrikulës dhe syllabuseve <i>[Evidencë 2.7]</i>, në përputhje me ndryshimet e tregut, me zhvillimet më të fundit të teknologjisë dhe ndryshimet e diktura nga aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.				
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është hartuar dhe organizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë. Njësia përgjegjëse disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</i> <i>Plani mësimor përmban të gjitha të dhënat e kërkuara lidhur me ndarjen e lëndëve, ngarkesën mësimore dhe organizimin e aktiviteteve brenda dhe jashtë auditorit. Institucioni ka përcaktuar qartë kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Megjithatë programi është i ri dhe nuk ka pësuar ndryshime në kurrikul, në aktet rregullatore të Institucionit parashikohen mekanizmat për rishikim dhe përditësim të vazhdueshëm.</i> <i>GVJ rekomandon që në syllabuset e lëndëve të specifikohet ngarkesa jashtë auditorit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 1.4]. Viti akademik është i organizuar në semestra. Format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët dhe praktikat. <i>Detyrat e kursit/projektet nuk janë parashikuar me ngarkesën përkatëse në kurrikul.</i> Kjo formë organizimi, ku studenti merr njohuri përmes leksioneve, seminareve dhe laboratoreve mundëson formimin e aftësive teorike dhe praktike të studentëve, në përputhje me nevojat e tregut të punës në fushën e nanoteknologjisë.

Ke

Gjergj

	Mungesa e detyrave të kursit/projekteve si pjesë përbërëse e lëndëve kufizon mundësinë për të aplikuar njohuritë e marra dhe për të përvetësuar kompetenca të rëndësishme në realizimin e detyrave individuale dhe në punën në grup.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë <i>[Evidencë 1.4]</i>: - Lëndë bazë (A) – 12 ECTS – 10.0%; - Lëndë karakterizuese (B) – 60 ECTS – 50.0%; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 22 ECTS – 18.3%; - Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS – 10.0%; - Detyrime përmbyllëse (E) – 14 ECTS – 11.7%; Si pjesë e lëndëve plotësuese (D) është parashikuar lënda “Praktikë profesionale”, gjithsej 12 ECTS. Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë “Temë diplome”, gjithsej 14 ECTS. Kjo formë organizimi u mundëson studentëve të përvetësojnë njohuri bazë, karakterizuese të profilit dhe integruese, duke siguruar një progres të qëndrueshëm dhe të strukturuar drejt arritjes së objektivave formues të programit të studimit. Lënda plotësuese “Praktika profesionale” ofron mundësinë për përvojën e parë të drejtpërdrejtë të studentëve në tregun e punës, duke i ndihmuar ata jo vetëm të përgatiten për sfidat profesionale, por njëkohësisht edhe të testojnë veten në një mjedis real pune. Tema e diplomës, si komponent përmbyllës i programit, synon realizimin e një studimi të thelluar mbi një temë specifike, duke i dhënë studentit mundësinë të thellojë njohuritë dhe të zhvillojë më tej specializimin e tij në një fushë të caktuar të nanoteknologjisë.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi,	Struktura e programit të studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare (Master i Shkencave në “Nanoshkencë dhe Nanoteknologji”, Universiteti Glasgow, Angli: link ; Master i Shkencave në “Nanoteknologji”, Instituti Mbretëror i Teknologjisë, Suedi: link ; Master i Shkencave në “Nanoshkencë”, Universiteti i Kopenhagen, Danimarkë: link ; Master i Shkencave në “Nanoshkencë dhe Nanoteknologji”, Universiteti i Barcelonës, Spanjë: link etj, në përputhje me formimin e kërkuar në tregun e punës në këtë profil brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar punësimin e shpejtë të

kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	studentëve brenda profilit të studimit [<i>Evidencë 1.3, Evidencë 1.4</i>].
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e veprimtarive formuese në leksione, seminare, laboratorë dhe praktikë profesionale është e balancuar dhe përmbush objektivat formues të programit. Raporti midis formimit teorik dhe praktik siguron aftësi të transferueshme në fusha të ndryshme të nanoteknologjisë, mbështet mobilitetin akademik dhe profesional të studentëve dhe rrit mundësitë për punësim të suksesshëm pas përfundimit të studimeve [<i>Evidencë 1.3, Evidencë 1.4</i>].
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” është një program i ri studimi dhe nuk i është nështruar ndryshimeve në kurrikul. Institucioni në aktet e tij rregullatore parashikon rishikimin e kurrikulës dhe syllabuseve [<i>Evidencë 2.7</i>], në përputhje me ndryshimet e tregut, me zhvillimet më të fundit të teknologjisë dhe ndryshimet e diktuar nga aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave, për t’u punësuar në fushën e nanoteknologjisë, në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të tretë Doktoratë në profilin e studimit.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit i përgatit të diplomuarit, në përputhje me nevojat e tregut të punës, brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar punësimin e shpejtë të tyre në profilin e studimit [<i>Evidencë 1.3, Evidencë 1.4</i>]. Programi siguron formim akademik dhe profesional, duke përfshirë njohuri bazë, të profilit dhe ndërdisiplinore, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të strukturuar të kompetencave të studentëve, në përputhje me objektivat formues të ciklit të studimeve. Lënda plotësuese “<i>Praktika profesionale</i>” luan një rol kyç në lidhjen e studentëve me realitetin e tregut të punës, duke u ofruar atyre një përvojë të drejtpërdrejtë në institucione dhe kompani që operojnë në fushën përkatëse. Praktika i ndihmon

	studentët të zhvillojnë aftësi praktike, të kuptojnë dinamikat e mjedisit të punës dhe të vlerësojnë në mënyrë të pavarur përgatitjen e tyre profesionale. “Tema e diplomës” përfaqëson fazën përmbyllëse të formimit akademik, duke u ofruar studentëve mundësinë për të zhvilluar një studim të avancuar mbi një temë të specializuar, në përputhje me drejtimin e programit. Ky komponent lejon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekspertizës në një fushë të caktuar të nanoteknologjisë, duke ndihmuar në përgatitjen e tyre për karrierë të suksesshme apo për studime të mëtejshme në nivel më të lartë.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me objektivat formues të ciklit të dytë, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, si dhe në harmoni me rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe kompetencat profesionale.</i> <i>Struktura e programit, ndarja e lëndëve dhe raporti midis formimit teorik dhe praktik janë të balancuara dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për vijimin e studimeve të ciklit të tretë, si dhe për punësim në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.</i> <i>Programi është i ri dhe ende nuk ka kaluar procesin e rishikimit periodik të syllabuseve, që parashikohet të ndodhë në përputhje me aktet rregullatore të institucionit.</i> <i>GVJ rekomandon përfshirjen e detyrave të kursit me ngarkesën përkatëse në kurrikul.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e	Për hartimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji”, si dhe për

përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	përshtatjen më të mirë me kërkesat e tregut të punës, njësitë përgjegjëse, Fakulteti i Ekonomisë, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, janë konsultuar gjerësisht me institucione partnere, të diplomuar dhe aktorë të tjerë të tregut të punës [Evidencë 1.3]. Në këtë proces, janë marrë parasysh propozimet dhe sugjerimet e Njesisë NanoAlb pranë Akademisë së Shkencave, partnerëve strategjikë të WBU, si Grupi i Spitaleve Amerikane dhe International Hygea Hospital, ndër të tjerë. Këto institucione kanë dhënë rekomandime të rëndësishme lidhur me nevojat dhe prioritetet e tregut, me fokus të veçantë në fushën e nanoteknologjisë. Kurrikula e programit është hartuar nga një grup ekspertësh të njohur në fushën e nanoteknologjisë nga Shqipëria, rajoni dhe Europa, nën drejtimin e Prof. Dr. A. M., një prej personaliteteve më të njohura në këtë fushë. Ajo bazohet në kërkesat aktuale të tregut të punës në sektorë të tillë si shëndetësia, mjedisi dhe bujqësia [Evidencë 6.10]. Gjithashtu, për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, merren në konsideratë edhe propozimet dhe <i>feedback</i>-u i studentëve gjatë dhe pas diplomimit (ALUMNI), si dhe sugjerimet nga aktorët kryesorë të tregut të punës, nëpërmjet mekanizmave të strukturuar të WBU.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit [Evidencë 2.5], këshilltarëve akademikë [Rregullore Institucionale, Neni 60] dhe me studentët e diplomuar përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e programit të studimit, procesit mësimor dhe stafit akademik nga studentët [Evidencë 2.7, Evidencë 2.8, Evidencë 3.5, Evidencë 3.6, Evidencë 3.9].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata,	Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Nanoteknologji” është një program i ri studimi dhe nuk i është nështruar ndryshimeve në kurrikul. Institucioni në aktet e tij rregullatore parashikon rishikimin e kurrikulës dhe syllabuseve [Evidencë 2.7] në bashkëpunim me profesionistë dhe institucione publike dhe private të fushës, në përputhje me ndryshimet e tregut, me zhvillimet më të fundit të teknologjisë dhe ndryshimet e diktuar nga aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

urdhëra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.				
Konkluzione	<i>Gjatë hartimit të kurrikulës janë marrë parasysh propozimet dhe sugjerimet e institucioneve partnere duke siguruar një përafrim të programit me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimet bashkëkohore në fushën e nanoteknologjisë.</i> <i>Institucioni ka vendosur mekanizma të qartë për konsultimin dhe mbledhjen e feedback-ut nga studentët aktualë dhe ata të diplomuar, nëpërmjet këshilltarëve akademikë, koordinatorëve, zyrës së karrierës dhe pyetësorëve të vlerësimit. Edhe pse programi është i ri dhe ende nuk i është nënshtruar procesit të përmirësimit të kurrikulës, aktet rregullatore të institucionit parashikojnë procedura të rishikimit periodik në bashkëpunim me rrjetet e profesionistëve dhe institucionet publike e private.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhore të institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Nanoteknologji” është hartuar në përputhje me fushat kryesore të mbuluara nga WBU, të përcaktuara në Statutin <i>[Statuti]</i>, Rregulloren Themelore <i>[Rregullore Institucionale]</i> dhe Planin Strategjik 2023–2030 <i>[Evidencë 1.2]</i>. Programi synon të thellojë njohuritë mbi nanomaterialet dhe aplikimet e tyre në fusha të ndryshme si biomjekësia, energjia dhe teknologjitë e informacionit, duke integruar inovacionin teknologjik me kërkimin ndërdisiplinor. Ai fokusohet në zhvillimin e njohurive të avancuara në nanoteknologji dhe përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfida komplekse dhe të paparashikueshme. Nëpërmjet promovimit të kërkimit shkencor inovativ dhe aplikativ, programi synon të nxisë ekspertizën në nanoteknologji dhe nanoshkencë, duke kontribuar në zhvillimin shkencor dhe ekonomik në Shqipëri, rajon dhe më

	gjerë. I konceptuar për të formuar profesionistë të kualifikuar, programi përgatit individë të aftë të kontribuojnë në sektorin privat dhe publik, si dhe në fushat e arsimit, kërkimit dhe teknologjisë, duke adresuar nevojat dhe sfidat e tregut global përmes kërkimeve të avancuara dhe zgjidhjeve inovative.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	DBI nxit dhe bashkërendon veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit, duke siguruar që aktivitetet akademike të zhvillohen në një mjedis të hapur dhe të larmishëm që respekton lirinë akademike të personelit [Statuti, Neni 68, fq. 38]. Departamenti ofron mundësi për zhvillim të pavarur të kërkimeve shkencore dhe pedagogjike, duke inkurajuar personelin akademik të përcaktojë dhe realizojë drejtime të reja kërkimore. Kjo qasje promovon bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe siguron që mësimdhënia dhe kërkimi të jenë në përputhje me standardet më të larta akademike, duke kontribuar në zhvillimin e një kulture shkencore inovative dhe të qëndrueshme.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	DBI inkurajon dhe mbështet përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore të iniciuara nga departamenti, fakulteti, universiteti, në bashkëpunim me institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare. Studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" janë angazhuar në internshipe, praktika profesionale dhe studime të thelluara, duke punuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me profesorë dhe ekspertë të fushës për zhvillimin e zgjidhjeve inovative për problematika reale. Në kuadër të bashkëpunimit me qendrën NanoAlb dhe nën drejtimin e pedagogëve, studentët kanë përgatitur temat e tyre të diplomës [Evidencë 1.17] dhe kanë marrë pjesë në aktivitete akademike dhe kërkimore shkencore si konferenca, simpoziume dhe Workshope [Evidencë 1.18].
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	DBI, mbështet financiarisht nga institucioni për organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme studimore, kërkimore dhe shkencore. Në përpjekje për të nxitur publikimet dhe aktivitetin shkencor, WBU ka hartuar udhëzime që rregullojnë procedurat për mbështetjen e publikimeve shkencore, pjesëmarrjen në konferenca dhe përfshirjen në aktivitete kërkimore shkencore të stafit akademik me kohë të plotë [Evidencë 2.19]. Këto udhëzime përfshijnë një procedurë efektive vlerësimi dhe financimi për publikime në revista të indeksuara [Evidencë 2.20] dhe për pjesëmarrjen në konferenca [Evidencë 2.22].

	Çdo vit akademik, Bordi i Administrimit të WBU përcakton fondin total për mbështetje të aktivitetit shkencor dhe publikimeve të stafit, si dhe vendos nivelin maksimal të bonusit financiar individual për arritjet në këtë fushë. Për promovimin e punës kërkimore, në universitet është themeluar revista shkencore "European Journal of Medical Sciences and Health Innovations", e cila shërben si platformë për publikimin e arritjeve shkencore të personelit akademik [Evidencë 2.21]. WBU ofron mbështetje financiare për kërkimin shkencor nëpërmjet projekteve të brendshme të financuara nga institucioni. Çdo vit akademik, shpallet thirrja për pjesëmarrje në këto projekte, e cila përfshin detaje mbi formatin e aplikimit, buxhetin dhe afatet përkatëse. Pas aplikimit, projektet vlerësohen dhe rankohen, dhe më pas shpallen ato që do të mbështeten financiarisht [Evidencë 2.24].			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me prioritetet strategjike të WBU, duke siguruar një kuadër të qartë për zhvillimin akademik dhe kërkimor. DBI bashkërendon veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit, duke promovuar një mjedis akademik që respekton lirinë e personelit dhe inkurajon bashkëpunimin ndërdisiplinor.</i> <i>DBI mbështet përfshirjen aktive të studentëve dhe stafit akademik në projekte kërkimore, duke ofruar mundësi dhe financim për kërkimin dhe zhvillimin e zgjidhjeve inovative.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera	Pranë DBI është krijuar grupi kërkimor <i>MediOmicsAI Research Group</i> [Evidencë 2.25]. DBI bashkëpunon me struktura të tjera kërkimore brenda dhe jashtë universitetit për të realizuar objektivat e programit të studimit në kërkim shkencor [Evidencë 1.9]. Departamenti inkurajon përfshirjen e studentëve dhe stafit në projekte kërkimore inovative të lidhura me fushat përkatëse, duke kontribuar në përparimin e njohurive

kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	shkencore dhe ndërtimin e një kulture kërkimore aktive [Evidencë 1.17]. Temat e diplomave të studentëve janë rezultat i këtyre projekteve. Një vend të rëndësishëm zë përfshirja e stafit dhe studentëve të këtij programi studimi në projekte dhe angazhime pjesë e njësive NanoAlb pranë Akademisë së Shkencave [Evidencë 1.20].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	DBI angazhohet vazhdimisht për t'iu përgjigjur kërkesave për studime kërkimore shkencore. Ky angazhim përfshin përfshirjen aktive të stafit akademik dhe studentëve në realizimin e objektivave përkatëse përmes projekteve të brendshme të financuara nga institucioni [Evidencë 2.24]. Çdo vit akademik hapet thirrje për aplikim në projekte kërkimore, ku përmes një procedure të strukturuar bëhet vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve që mbështeten financiarisht.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Institucioni, gjatë v.a. 2023–2024, ka organizuar disa aktivitete me pjesëmarrjen aktive të studentëve të programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Nanoteknologji”: • <i>The 1st edition of the NanoBalkan International Conference</i> (NB2023), organizuar nga Phantom Foundation, the Catalan Institute of Nanoscience and Nanotechnology, Spain, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe NanoAlb (https://www.nanobalkanconf.com/2023/) • <i>The 2nd edition of the NanoBalkan International Conference</i> (NB2024), organizuar nga Phantom Foundation, the Catalan Institute of Nanoscience and Nanotechnology, Spain, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe NanoAlb, etj. (https://www.nanobalkanconf.com/2024/) • Workshop mbi përfundimin e projekteve NanoAlb (Maj 2022–Maj 2024), organizuar nga NanoAlb dhe Akademia e shkencave e Shqipërisë, më 25 Qershor 2024. • Workshop mbi lançimin e projekteve të reja të thirrjes “The 3rd NanoAlb Ignite Projects”, organizuar nga NanoAlb dhe Akademia e shkencave e Shqipërisë, më 26 Qershor 2024 – në një prej të cilave EBU është partner. • Vizitë studimore në Universitetin “Goce Delcev” (GDU), Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut⁶⁰.

	• Vizitë studimore në Forensic Center Albania (FCA), etj. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është angazhimi i ekspertëve të jashtëm me leksione të hapura dhe aktivitete, duke ndarë eksperiencën e tyre me stafin akademik dhe studentët e EBU [Evidencë 2.31, Evidencë 2.32].
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" synon formimin e profesionistëve të kualifikuar dhe konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Përmbajtja kurrikulare përfshin module të avancuara teorike dhe praktike në përputhje me zhvillimet më të fundit shkencore dhe teknologjike në fushën e nanoteknologjisë. Programi promovon aftësi kërkimore, analitike dhe teknike, duke përfshirë studentët në projekte reale kërkimore dhe inovative, në bashkëpunim me institucione akademike dhe industrinë. Lidhjet e ngushta me industrinë, qasja ndërdisiplinore dhe promovimi i aftësive të transferueshme i bëjnë të diplomuarit të aftë të konkurrojnë në një treg pune gjithnjë e më global dhe të ndërlidhur.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	DBI angazhohet në zbatimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale dhe rrjetet profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) [Evidencë 1.3, Evidencë 1.10]. Zbatimi i këtyre rekomandimeve garanton që përmbajtja akademike dhe praktikat formuese të jenë të përditësuara, të orientuara drejt kërkesave profesionale dhe të kontribuojnë në përgatitjen cilësore të studentëve në fushën e nanoteknologjisë. Gjithashtu, bashkëpunimi i ngushtë me shoqatat dhe rrjetet profesionale mundëson lidhjen efektive të teorisë me praktikën dhe rrit angazhimin e studentëve në aktivitete kërkimore dhe zhvillimore që lidhen me profesionin. Gjithsesi ky program studimi po kalon akreditimin për herë të parë, kështuqë për momentin nuk mund të kryejë ndryshime madhore.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh.	N / A

41

Gauti

<i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).</i>				
Konkluzione	DBI dëshmon një angazhim të qëndrueshëm për mbështetjen e grupeve kërkimore, përfshirjen aktive të stafit dhe studentëve në projekte kërkimore, bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit, organizimin e konferencave dhe aktiviteteve, si dhe zbatimin e rekomandimeve nga urdhrat dhe shoqatat profesionale. Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" kontribuon në përgatitjen e studentëve me kompetenca të përshtatshme për të qenë konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe	Ngarkesa në auditor e studentëve [Tabelat përmbledhëse, Tabela 13] është e organizuar në leksione (615 orë), seminare (225 orë), ushtrime/laboratorë (165 orë), forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (15 orë), praktikë profesionale (250 orë) dhe diploma (30 orë), gjithsej 1300 orë.

çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Mësimdhënia në programin e studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është kombinim i njohurive teorike me ato praktike [<i>Evidencë 1.4</i>], me synimin për të zhvilluar aftësitë e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Personeli akademik i kushton vëmendje të veçantë përshtatjes së metodave të mësimdhënies me nevojat e studentëve, duke promovuar një qasje fleksibile dhe të orientuar drejt studentit. Institucioni disponon infrastrukturë të avancuar teknologjike dhe laboratorike, e cila mundëson zhvillimin interaktiv të procesit mësimor si në mjediset e klasës, ashtu edhe gjatë orëve praktike laboratorike [<i>Evidencë 1.7</i>, <i>Evidencë 1.8</i>].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Institucioni mbështet në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin profesional të personelit akademik, duke ofruar trajnime dhe mundësi kualifikimi për përmirësimin e kompetencave didaktike [<i>Evidencë 3.1</i> , <i>Evidencë 3.3</i>]. Nevojat për zhvillim identifikohen përmes pyetësorëve të strukturuar, të drejtuar si ndaj stafit akademik, ashtu edhe atij administrativ [<i>Evidencë 3.2</i>].
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në programin e studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" janë angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në fushën e studimit [<i>CV stafi</i>]. Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive, duke futur edhe koncepte praktike të fushës për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson	DBI kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinators [<i>Evidencë</i>

format e metodat e mësimitdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	2.5], këshilltarëve akademikë [Rregullore Institucionale, Neni 60] dhe me studentët e diplomuar përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e programit të studimit, procesit mësimor dhe stafit akademik nga studentët [Evidencë 2.7, Evidencë 2.8, Evidencë 3.5, Evidencë 3.6, Evidencë 3.9]
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimitdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimitdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimitdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimitdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në WBU është themeluar dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit, i cili koordinon punën e tij me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [Evidencë 3.10, Evidencë 3.11, Evidencë 3.12, Evidencë 3.13]. Pjesëmarrja e WBU në projektin Erasmus+ QA-SURE [Evidencë 3.14], ka mundësuar rritjen dhe forcimin e kapacitetit të Institucionit në drejtim të sigurimit të cilësisë. Si pjesë e aktiviteteve të projektit janë përgatitur Paketa e cilësisë dhe Plani i aktiviteteve sipas udhëzimeve të <i>European Standard Guidelines</i> , në bashkëpunim me partnerë nga Shqipëria, Kosova dhe Europa. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, është zhvilluar një indeks për performancën akademike, që mbështet cilësinë. Ky indeks përfshin përditësimin e rregullt të treguesve të performancës dhe është bërë pjesë integrale e procesit të monitorimit nga NJSBC, duke qenë i disponueshëm për gjithë personelin. Vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë mbështetet edhe nga vlerësimet e studentëve për mësimitdhënien, përmbajtjen e kurseve, metodat mësimore dhe performancën e përgjithshme të stafit akademik [Evidencë 2.7].
Konkluzione	<i>Format dhe metodat e mësimitdhënies në programin e studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" janë një kombinim i mirë midis teorisë dhe praktikës, duke përfshirë leksione, seminare, laboratorë dhe praktika profesionale.</i> <i>Personeli akademik dëshmon përkushtim në përshtatjen e mësimitdhënies me nevojat e studentëve, duke përdorur metoda interaktive dhe duke nxitur përfshirjen aktive të tyre. Vlerësimi dhe përmirësimi i metodave të mësimitdhënies kryhen në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë feedback-un e studentëve dhe duke u mbështetur në struktura të dedikuara institucionale për sigurimin e cilësisë. Trajnimet e rregullta dhe bashkëpunimet ndërkombëtare kontribuojnë në</i>

	profesionalizmin e stafit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në rregulloren themelore të institucionit <i>[Rregullore institucionale, Kreu 12]</i> përcaktohet sistemi i vlerësimit të studentëve. Provimet zakonisht bëhen me shkrim. Pedagogu i lëndës mundet që të vendosë ta bëjë provimin me gojë, në formë projekti ose detyrë kursi. Për çdo lëndë të ndjekur, studenti vlerësohet nga pedagogu në përfundim të semestrit me një nga notat e mëposhtme:				
	Nota (sipas sistemit shqiptar)	Shpjegimi i Notës	Vlerësimi i brendshëm i Universitetit Ëestern Balkans		Koeficienti sipas sistemit amerikan
			Pikët	Nota Shkronjë	
	10	Shkëlqyeshëm	90-100	A	4.00
	9	Shumë mirë	85-89	A-	3.50
	8	Mirë	75-84	B	3.00
	7	Kënaqshëm	65-74	B-	2.50
	6	*Mjaftueshëm me kusht	55-64	C	2.00
	5	*Kalueshëm me kusht	50-54	D	1.00
	4	Jo kalues	0-49	F	0.00
*Studenti i cili ka këto nota, duhet të ketë mesataren e përgjithshme mbi 7 për tu diplomuar në Universitetin “Western Balkans”.					

Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga titullarët e lëndëve mbi format e vlerësimit të lëndës të parashikuara në syllabus <i>[Syllabuse]</i> . Syllabuset bëhen të disponueshme për studentët edhe në platformën Smart WBU dhe <i>Google Classroom</i> të lëndës. Çdo pedagog, brenda javës së parë të semestrit, publikon sistemin e vlerësimit të lëndës përkatëse në platformën Smart WBU <i>[Evidencë 3.32]</i> .			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Pedagogu zgjedh format më të përshtatshme të vlerësimit në përputhje me natyrën e lëndës dhe objektivat e të nxënës. Metodot e përdorura përfshijnë provime me shkrim (ndonjëherë edhe me gojë apo në formë të kombinuar), provime të ndërmjetme (<i>midterm</i>), provime përfundimtare (<i>finale</i>), seminare, teste, projekte individuale ose në grup, prezantime, punë laboratorike dhe praktika profesionale <i>[Rregullore institucionale, Kreu 12]</i> . Të gjitha format e vlerësimit janë të përcaktuara në <i>syllabus</i> -in përkatës dhe synojnë një vlerësim gjithëpërfshirës të arritjeve të studentëve <i>[Syllabuse]</i> . Këto metoda u japin studentëve mundësinë të shfaqin kompetencat e tyre në mënyra të ndryshme, të marrin <i>feedback</i> të rregullt për performancën dhe të përmirësojnë vazhdimisht rezultatet e tyre akademike.			
Konkluzione	<i>Sistemi i vlerësimit është i përcaktuar qartë në rregulloren themelore të institucionit dhe është i njohur për studentët. Syllabuset për secilën lëndë përmbajnë informacion të detajuar mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit. Studentëve u ofrohen forma të ndryshme të vlerësimit që përfshijnë komponentë të testimit teorik dhe praktik, duke iu dhënë mundësinë të shfaqin njohuritë dhe kompetencat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë semestrit, duke përfshirë angazhimin aktiv të studentit në forma të ndryshme si: provimet e ndërmjetme (<i>midterm</i>) dhe përfundimtare (<i>final</i>), detyrat individuale apo në grup, testet, prezantimet, punimet laboratorike dhe projektet [<i>Tabelat përmbledhëse, Tabela 15</i>]. Këto forma i japin studentit mundësinë të shfaqë progresin e tij në mënyrë graduale dhe të shumëllojshme. Nota përfundimtare pasqyron performancën e përgjithshme të studentit gjatë vitit akademik, duke reflektuar nivelin e përgatitjes, aftësitë e fituara dhe përmbushjen e objektivave të të nxënit të përcaktuara në <i>syllabus-in</i> [<i>Syllabuse</i>] e çdo lënde apo moduli [<i>Rregullore institucionale, Kreu 12</i>].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	WBU ka implementuar sistemin elektronik të testimit dhe vlerësimit në platformën Smart WBU [<i>Evidencë 3.32</i>], i cili garanton një proces transparent dhe të barabartë për studentët. Përmes tij, testimet zhvillohen në mënyrë të strukturuar dhe objektive, rezultatet regjistrohen menjëherë, ndërsa çdo veprim ruhet duke mundësuar analizë dhe raportim të lehtësuar.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nota përfundimtare e studentit përcaktohet nga të gjithë komponentët e vlerësimit të parashikuar për lëndën në <i>syllabus-in</i> përkatës [<i>Syllabuse, Tabelat përmbledhëse, Tabela 15</i>]. Rezultatet e arritura pasqyrohen në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit, regjistrin e notave dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave akademike.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pas çdo testimi, provimi, seminari apo dorëzimi të projekteve dhe detyrave të kursit, studentët njihen me rezultatet dhe marrin <i>feedback</i> nga pedagogu, duke u dhënë mundësinë të reflektojnë dhe të përmirësojnë performancën. Nëse kërkohet mbështetje shtesë, titullarët e lëndëve ofrojnë konsultime individuale ose në grup, si dhe ushtrime apo detyra shtesë, për t'i ndihmuar studentët në zhvillimin e aftësive dhe përgatitjen për vlerësimet e ardhshme. Për këtë qëllim, çdo pedagog ka një ditë dhe orar të përcaktuar për konsultime me studentët e interesuar.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk	Institucioni, në kuadër të projektit Erasmus+ QA-SURE, është pajisur me mjete digjitale për kontrollin e plagjiaturës, si Turnitin dhe AI Detector [<i>Evidencë 3.21</i>]. Parimet e etikës

lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	akademike janë të detyrueshme për të gjithë studentët dhe të sanksionuara qartë në rregulloret institucionale dhe në Kodin e Etikës [Evidencë 3.22].			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në përfundim të provimit, pedagogu, pasi ka vlerësuar fletët e provimit, plotëson procesverbalin e vlerësimit dhe e dorëzon pranë Sekretarisë Mësimore. Rezultatet i bëhen të ditura studentëve brenda dy javësh nga data e provimit. Procesverbalet nuk duhet të përmbajnë shënime apo korrigjime, ndërsa çdo ndryshim lejohet vetëm nëse është i justifikuar dhe i dokumentuar [Rregullore institucionale, Kreu 12, Neni 98].			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin e provimit brenda një jave nga dita e shpalljes së tij, duke paraqitur një kërkesë pranë Sekretarisë Mësimore [Rregullore institucionale, Kreu 12, Neni 99].			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Pas paraqitjes së ankesës nga studenti për vlerësimin e provimit, Këshilli i Departamentit ngre një komision me tre anëtarë, ku nuk mund të përfshihet pedagogu i lëndës. Komisioni shqyrton fletën e provimit në bazë të ankesës dhe njofton studentin për vendimin e marrë brenda 15 ditësh nga data e paraqitjes së ankesës [Rregullore institucionale, Kreu 12, Neni 99].			
Konkluzione	WBU ka ngritur një sistem vlerësimi të qartë dhe të strukturuar. Vlerësimi përfundimtar bazohet në komponentë të ndryshëm që pasqyrojnë progresin real të studentëve. Përdorimi i platformave elektronike rrit transparencën, ndërsa procedurat për trajtimin e ankesave dhe rishikimin e notave janë të dokumentuara dhe të mirëstrukturuara. Masat parandaluese kundër plagjiaturës dhe respektimi i Kodit të Etikës sigurojnë ndershmërinë akademike. Feedback-u i vazhdueshëm dhe konsultimet me pedagogët nxisin përmirësimin e vazhdueshëm të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" garanton thellimin e njohurive të avancuara në fushën e nanoteknologjisë, duke synuar zhvillimin e aftësive profesionale dhe kërkimore të studentëve [Evidencë 1.4]. Përmes moduleve të specializuara, punës praktike në laboratorë modernë, projekteve kërkimore dhe angazhimit në problematika reale, studentët përgatiten për të analizuar, projektuar dhe aplikuar teknologji në shkallë nano në sektorë si industria farmaceutike, energjia, biomjekësia etj. Programi synon jo vetëm përvetësimin e njohurive të thelluara, por edhe zhvillimin e kompetencave shkencore për të kontribuar në fushën akademike dhe në tregun e punës me profesionalizëm dhe inovacion.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" mundëson zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit përmes përdorimit të platformave dixhitale për analizë dhe modelim në shkallë nano, si dhe softuerëve të avancuar për simulime shkencore [Evidencë 1.4]. Studentët përfshihen në aktivitete që forcojnë kompetencat humane dhe sociale, përmes punës në grup, projekteve ndërdisiplinore dhe pjesëmarrjes në debate akademike që zhvillojnë mendimin kritik. Gjithashtu, theksohet rëndësia e aftësive të komunikimit shkencor, si në formë të shkruar ashtu edhe të prezantuar, në gjuhën angleze, gjë që mundëson ndërveprim të efektshëm në mjedise akademike dhe profesionale ndërkombëtare.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të	Gjatë orëve të fundit të mësimit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara [Syllabuse].

rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikën profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" [Evidencë 1.4] është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët të kompetencave profesionale në fushën e nanoteknologjisë. Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, WBU ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët e biznesit vendas dhe të huaj [Evidencë 1.9]. Këto marrëveshje mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave të stafit dhe studentëve, zhvillimin e praktikave mësimore, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara [Evidencë 2.17, Evidencë 2.33, Evidencë 3.21].
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjatë vitit akademik 2023–2024, WBU ka zhvilluar një kalendar të gjerë veprimtarish akademike dhe shkencore. Në fokus kanë qenë prezantimi i prurjeve më të fundit në fushën e shkencës dhe teknologjisë përmes orëve të hapura, trajnimeve, webinarëve dhe takimeve tematike. Në këto aktivitete kanë kontribuar ekspertë dhe personalitete të njohura, vendase dhe të huaja, duke krijuar një hapësirë bashkëpunimi ku si stafi akademik, ashtu edhe studentët, kanë marrë pjesë aktive dhe ndërvepruese [Evidencë 2.32].
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga	Institucioni nxit dhe mbështet idetë inovative dhe studimet e avancuara të studentëve përmes vënies në dispozicion të infrastrukturës së disponueshme, stafit akademik dhe administrativ për mentorimin e tyre dhe financiarisht përmes

studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	projekteve të brendshme të financuara nga institucioni [Evidencë 2.24].			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" garanton një formim të thelluar akademik dhe profesional, duke i pajisur studentët me njohuri të avancuara, aftësi kërkimore dhe kompetenca ndërdisiplinore në përputhje me kërkesat bashkëkohore të tregut.</i> <i>Përmes kurrikulës së orientuar drejt zhvillimit të kompetencave praktike në laboratorë modernë dhe përfshirjes aktive në projekte reale, studentët aftësohen të analizojnë dhe zbatojnë zgjidhje inovative në fushat ku aplikohen teknologjitë nano.</i> <i>Organizimi i orëve të hapura dhe seminareve me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe mbështetja për kërkimin shkencor dhe idetë inovative, dëshmojnë për një mjedis akademik dinamik dhe në funksion të avancimit të dijes dhe formimit cilësor të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka përgatitur dhe vë në dispozicion të studentëve diplomantë një udhëzim, i cili synon të qartësojë, thjeshtojë dhe promovojë përsosmërinë në shkrimin dhe prezantimin e temës së diplomës [Evidencë 3.28]. Ky material udhëzues e shoqëron studentin hap pas hapi gjatë procesit të hartimit të diplomës dhe njëkohësisht shërben si referencë praktike për mënyrën e raportimit të rezultateve në çdo projekt të ardhshëm ku ata mund të angazhohen.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e	Udhëzimet për shkrimin e diplomës ju bëhen të disponueshme studentëve përmes pedagogëve udhëheqës, këshilltarëve akademikë dhe në formë elektronike në platformën Smart WBU. Staf i akademik mbetet gjithmonë në dispozicion për çdo orientim shtesë, si dhe për sqarimin e paqartësive apo

nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	vështirësive që studentët mund të hasin gjatë zbatimit të udhëzimeve.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" përmbyllin studimet e tyre me temë diplome, duke thelluar njohuritë e tyre teorike dhe praktike në një temë specifike të fushës <i>[Evidencë 1.4]</i>. Temat e diplomave të miratuara janë pjesë e studimeve kërkimore të stafit akademik dhe zhvillohen pranë laboratoreve të institucionit dhe institucioneve partnere <i>[Evidencë 2.2]</i>.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik dhe udhëheqësit e diplomave ndihmojnë studentët në përzgjedhjen e temave që janë në përputhje me objektivat e programit dhe zhvillimet më të fundit në fushën e nanoteknologjisë. Udhëheqësit ofrojnë mbështetje të vazhdueshme në formulimin e qëllimeve kërkimore, analizën dhe përpunimin e rezultateve, si dhe në përgatitjen e dokumentit përfundimtar në përputhje me udhëzuesin e diplomës <i>[Evidencë 3.28, Evidencë 3.29]</i> .
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët mund të kryejnë analizat dhe matjet në kuadër të temave të diplomës në laboratorët e institucionit <i>[Evidencë 1.7]</i> dhe në institucionet partnere (pjesë e njësisë NanoAlb, Grupi i Spitaleve Amerikane dhe International Hygea Hospital sh.a., Cambridge Clinical Laboratories, etj.) <i>[Evidencë 1.10, Evidencë 1.11]</i> .
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Tema e diplomës vlerësohet me notë, si çdo lëndë tjetër e kurrikulës <i>[Evidencë 1.4]</i> . Ashtu sic jemi shprehur edhe me sipër, notat variojnë nga nota 4-10, me notë kaluese 5. Gjithsesi, studentët e rregjistruar në WBU duhet të kenë një mesatare 7 që të arrijnë të marrin diplomën në këtë institucion.

Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët, të cilët përfundojnë me sukses studimet në fakultetet e Universitetit Western Balkans, në zbatim dhe përputhje të kësaj rregulloreje, pajisen me diplomën përkatëse, të regjistruar paraprakisht në Regjistrin e Diplomave dhe të Certifikatave në Ministrinë përgjegjëse për arsimin [<i>Rregullore institucionale, Neni 86, Evidencë 3.30</i>].			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	WBU garanton ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dokumentacioni mbahet si në formë fizike, ashtu edhe elektronike, nga Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës [<i>Rregullore institucionale, Neni 46</i>]. Kjo zyrë është përgjegjëse për arkivimin dhe përdorimin efektiv të dokumenteve institucionale. Për dokumentacionin specifik të studentëve, Sekretaria Mësimore ka kompetencë të plotë mbi regjistrimin, arkivimin dhe përditësimin e të dhënave si: informacioni personal, ecuria akademike, diplomat dhe suplementet përkatëse. Të dhënat ruhen në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe parimin e konfidencialitetit. Përmes platformës SMART WBU, dokumentacioni i studentëve është i dixhitalizuar sipas njësive përkatëse. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave realizohet nga Sekretaria Mësimore në përputhje me Rregulloren mbi organizimin administrativ [<i>Evidencë 1.16, Neni 31</i>].			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron udhëzues të detajuar për përgatitjen e temës së diplomës dhe ofron mbështetje të vazhdueshme për realizimin e matjeve dhe analizave, duke mundësuar realizimin me sukses të projektit të diplomës.</i> <i>Institucioni disponon një sistem të strukturuar për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve, i cili siguron që të dhënat janë të ruajtura në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6				
Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A			
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A			
Konkluzione	GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

K.

[Signature]

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																																					
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																				
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në RVB konstantohet se personeli akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personeli ndihmës akademik janë angazhuar në realizimin e programit dhe përmbushin kërkesat ligjore, të cilat përfshijnë nivelin akademik, drejtimin e programit, mbulimin e lëndëve etj. Profili i personelit akademik dhe ndihmës akademik të WBU-së është në përputhje me drejtimet kërkimore shkencore të programit të studimit, natyrën dhe veçoritë e moduleve të tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion (<i>Tabelat përmbledhese për Aneks_RVB Shqip Nanoteknologji. tab 6.1-6.2</i>) për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Msc në Nanoteknologji janë angazhuar për dy vite akademike staf akademik me kualifikimin si më poshtë:																																				
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr> <tr> <th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>1</td></tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td><td>3</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td><td>2</td><td>2</td><td>5</td><td>2</td></tr> <tr> <td>Msc.</td><td>1</td><td>-</td><td>2</td><td>1</td></tr> <tr> <td>Totali</td><td>6</td><td>2</td><td>9</td><td>4</td></tr> </tbody> </table>				Tituj/ grada	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	1	1	Prof. Asoc.	3	-	1	-	Dr./PhD.	2	2	5	2	Msc.	1	-	2	1	Totali	6	2	9
Tituj/ grada	2023-2024		2024-2025																																		
	PAE	PAK	PAE	PAK																																	
Prof.Dr.	-	-	1	1																																	
Prof. Asoc.	3	-	1	-																																	
Dr./PhD.	2	2	5	2																																	
Msc.	1	-	2	1																																	
Totali	6	2	9	4																																	
Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në Nanoteknologji, (edhe pse një numër i vogël) janë angazhuar edhe staf																																					

	akademik me Msc, në ndryshim nga parashikimi i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: “<i>Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës</i>”. Për vitin akademik 2023-2024 12.5% e stafit janë me Msc; Për vitin akademik 2024-2025 23% e stafit janë me Msc; <i>GVJ rekomandon që, për realizimin e programit të studimit Msc Nanoteknologji, Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i>															
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga verifikimi i të dhënave (ref. Tabelave 12.1, - 12.2), u konstatua se për dy vitet akademike mbulimi i ngarkesës mësimore sipas viteve akademike është si vijon: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>23 - 24</td><td>630</td><td>435</td><td>195</td><td>70% / 30%</td></tr><tr><td>24 - 25</td><td>1050</td><td>720</td><td>330</td><td>71% / 29%</td></tr></table> Nga sa më sipër rezulton se për të 2 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, <u>është përballuar në kufijt minimal me mbi 70%</u> nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “<i>Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi</i>”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	23 - 24	630	435	195	70% / 30%	24 - 25	1050	720	330	71% / 29%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)												
23 - 24	630	435	195	70% / 30%												
24 - 25	1050	720	330	71% / 29%												
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Referuar shqyrtimit të DVV-së, konstantohet qëndrueshmëria e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit. Zyra e Burimeve Njërëzore siguron kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore [evidenca 4.6].															
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur	Procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në dokumentet e brendshme të institucionit.															

në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në Nenin 71 të Statutit të WBU-së, si dhe rregulloren e punësimit [evidencat 1, 4.11] vihet re se është ndjekur procedura për rekrutimin dhe vlerësimin, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura. Rekrutimi dhe vlerësimi kanë garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit (personeli mësimor dhe kërkimor), strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar rregullores mbi organizimin akademik [evidenca 1.14] konstatohet se WBU siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, të nevojshme për programin e studimit.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Personeli për këtë program zgjidhet në fillim të vitit akademik, bazuar në kriteret e paracaktuara nga kuadri ligjor dhe rregulloret e brendshme. WBU ka në strukturën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ. Baza e të dhënave e disponuar përditësohet vazhdimisht në përputhje me numrin total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program dhe mbulimit të ngarkesës së programit. Kjo zyrë menaxhon rekrutimin, detyrimet, ndryshimet e detyrave të punës dhe politikat e punësimit të stafit, si dhe mban të dhëna të detajuara për gjithë personelin, përfshirë stafin akademik, koordinatorët e programeve, stafin mbështetës dhe administrativ. Njëkohësisht, zyra përditëson dosjet e personelit, mban kontratat e punës dhe mbikëqyr përfundimin e tyre. [evidenca 1.16].
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e	Konstatohet se Universiteti Western Balkans ka marrëveshje e bashkëpunim me IAL të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani [evidenca 4.15]. Kjo ndihmon udhëheqjen e diplomave, praktikën profesionale, mbikëqyrjen e studentëve etj. WBU ka bashkëpunim me partnerë vendor e ndërkombëtarë, të cilët ndihmojnë studentët në realizimin e

mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	praktikave profesionale dhe kërkimeve shkencore për realizimin e temave të diplomës. Referuar RVB praktikat profesionale, punimi i diplomës dhe veprimtari të tjera specifike zhvillohen nën mbikëqyrjen e personave përgjegjës sipas rastit, përgjegjësit të departamentit, koordinatorëve dhe udhëheqësve.			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Referuar rregullores themelore WBU [evidenca 2] konstantohet se personeli mbikqyrës ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës, si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. WBU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet partnere, si me Shoqërinë American Hospital SH.A dhe International Hygea Hospital SH.A, [Evidenca Nr.1.10] Cambridge Clinical Laboratories etj [Evidenca Nr.1.11], ku kryhen praktikat profesionale, në kuadër të formimit të plotë teorik dhe praktik të studentëve. Praktikrat profesionale kryhen në grupe të vogla, deri në 20 studentë dhe vlerësohen me notë, si në detyrimet e tjera të studentëve. Studentët janë të detyruar t'i ndjekin këto praktika profesionale.			
Konkluzione	<i>Stafi akademik i agazhuar në programin e studimit përgjithësisht i plotëson kërkesat ligjore për ngarkesat mësimore, me personel të kualifikuar (me përjashtim të një numri të vogël) dhe me përvojë.</i> <u>GVJ rekomandon që, për realizimin e programit të studimit Msc Nanoteknologji, Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</u> <i>Personeli i posaçëm akademik është në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i> <i>WBU bashkëpunon me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë për praktika profesionale dhe projekte kërkimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, natyrës specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ vlerëson se WBU ka siguruar mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, natyrës specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. WBU ka në dispozicion kampusin universitar me 3 godina, ambient parkimi dhe oborr. Godinat përmbajnë hapësira të mjaftueshme infrastrukturore për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara për realizimin e programit master në Nanoteknologji (salla për leksione, seminare e konferenca; ambiente për laborator; salla për internet dhe aktivitete promovuese; sallë biblioteke me dhoma studimi; mjedise administrative, zyra për personelin akademik dhe administrativ dhe salla mbledhjesh). [evidenca 4.17]; [evidenca 4.18]; [evidenca 4.19];
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ gjatë vizitës në ambientet e WBU konstatoi se disponohen klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, të cilat janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Laboratorët janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për procesin mësimor. Zyrat e personelit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme të punës, duke përfshirë pajisjet teknologjike dhe elektronike. Këto mjedise kanë tabela inteligjente (SMART BOARDS) që përdoren gjatë procesit mësimor. [evidenca 4.20]; [evidenca 4.21]
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e	Për programin e studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" realizimi i seminareve, detyrave të kursit dhe projekteve kërkon mbështetjen e një baze të fuqishme informatike. Në WBU funksionojnë 27 laboratorë, studio e mjedise të tjera mësimore. Ato janë të pajisura me aparatura, pajisje dhe mjete bashkëkohore të përshtatshme për

nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	plotësimin e kërkesave të moduleve. Ambientet laboratorike janë të pajisura me mjetet e nevojshme për procesin mësimor dhe me manualët e laboratorit, sipas specifikave të tyre. Mbetjet laboratorike trajtohen sipas marrëveshjes së evadimit. [Evidenca Nr.4.22]; [Evidenca Nr.4.23]; [Evidenca Nr.4.24]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, WBU ka në dispozicion tre laboratorë të teknologjisë së informacionit: - Laboratori i Shkencave Kompjuterike të Inteligjencës Artificiale; - Laboratori i Shkencave Kompjuterike të Sigurisë Kibernetike; - Laboratori i Shkencave Kompjuterike të Inxhinierisë Software; Përmes SMART WBU realizohet informatizimi i dokumentacionit, si dhe të proceseve dhe procedurave në funksion të veprimtarive institucionale. Studentët kanë në dispozicion bibliotekën dhe një databazë digjitale dhe laboratorin e VR (Virtual Reality), i cili ndihmon studentët të realizojnë seanca të posaçme mësimore. [Evidenca Nr.4.25]; [Evidenca Nr.4.26]; [Evidenca Nr.4.27]
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore	Konstantohet se WBU ka një rrjet partnerësh, siç janë Akademia e Shkencave të Shqipërisë [evidenca 5.], Cambridge Clinical Laboratories [evidenca 1.9]. Këto bashkëpunime garantojnë që mjediset e vëna në dispozicion janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale.”

dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	WBU ka në dispozicion ambjentë të mjaftueshme për zhvillimin e procesit akademik. Mjediset mësimore janë të pajisura me mjete audio vizive, si: PC, projektore, foni dhe internet. Mjediset mësimore dhe laboratorët janë të pajisura me teknologji moderne. WBU bashkëpunon me partnerë për praktikat profesionale dhe projektet kërkimore, duke përdorur teknologjinë SMART WBU për informatizimin e dokumentacionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe e rekomanduar në syllabuset e lëndëve është në gjuhën angleze, në përputhje me gjuhën në të cilën ofrohet programi i studimit. Kjo literaturë vihet në dispozicion të studentëve pranë bibliotekës së WBU-së, si në formë fizike ashtu edhe elektronike, falë anëtarësimit të institucionit në platformat JSTORE [Evidencë 4.26] dhe Research4Life [Evidencë 4.27]. Materialet e vëna në dispozicion, mbi bazën e të cilave janë hartuar edhe syllabuset, sigurojnë marrjen e njohurive në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nisur nga syllabuset e lëndëve [Syllabuse], të vëna në dispozicion pas vizitës në Institucion, <u>vihet re që në disa lëndë, literatura bazë dhe e rekomanduar nuk është e pesë viteve të fundit</u> (p.sh. lënda "Nanobiologji", literaturë e vitit 2009, lënda "Hyrje në nanoshkenca dhe nanoteknologji", literaturë e vitit 2010 dhe 2015, etj)
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar	Studentët dhe stafi akademik mund të përdorin ambjentet e bibliotekës për të punuar dhe studiuar, aksesuar në literaturën fizike dhe atë online. Në faqen web të bibliotekës (https://library.wbu.edu.al/sq/resources), ata mund të marrin

Handwritten signature

Handwritten signature

mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	informacion mbi burimet e vëna në dispozicion. Burimet <i>online</i> mund të aksesohen brenda rrjetit të universitetit përmes regjistrimit me emailin institucional, ndërsa jashtë rrjetit realizohet në mënyrë “remote” përmes Pikës Qendrore të Regjistrimit, në varësi të licencës. Stafi i bibliotekës është në dispozicion të të interesuarve, nëse ata kanë nevojë për informacion mbi burimet e kërkuara apo udhëzime gjatë kërimit <i>online</i> .
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e WBU (https://library.wbu.edu.al/) është ndërtuar mbi bazën e nevojave që burojnë nga kurrikulat e ofruara. Ajo ofron mbi 30.000 tituj literaturë fizike, të cilët mbulojnë nevojat për realizimin me sukses të programeve të studimit, zbatimin e syllabuseve, zhvillimin e praktikave profesionale dhe përgatitjen e temave të diplomës. Në këtë program studimi, një vend qendror zë literatura në gjuhën angleze, ndërkohë që biblioteka ofron edhe literaturë mbështetëse në gjuhën shqipe. Biblioteka mundëson huazimin e burimeve fizike për një periudhë të caktuar kohe në përputhje me rregulloren e saj [Evidencë 4.30].
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Bibliotekat <i>online</i> ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët dhe stafin akademik, pa asnjë dallim. Mënyrat e aksesimit janë të shpjeguara më sipër në Kriterin 3 të këtij standardi.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e WBU vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik kompjutera me teknologjinë e nevojshme <i>software</i> për të aksesuar bibliotekat <i>online</i> . Aksesimi i bibliotekave <i>online</i> mundësohet jo vetëm përmes këtyre kompjuterave, por në të gjithë kompjuterat e lidhur në rrjetin e WBU.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në	Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik gjatë orarit zyrtar të punës (08:30–16:30), i cili shpallet në ambientet e saj dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit. Ndërkohë, fondi dixhital mund të aksesohet në çdo kohë sipas përcaktimeve në Kriterin 3 të këtij standardi.

përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka, në bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhduar me njësitë bazë, garanton ofrimin e literaturës më të fundit për studentët dhe stafin akademik, duke i informuar ata për çdo titull të ri që i shtohet koleksionit. Biblioteka është përgjegjëse për mbajtjen dhe përditësimin e statistikave mbi cilësinë dhe përmbajtjen e fondit fizik dhe atij online, shkallën e shfrytëzimit nga studentët dhe personeli akademik, si dhe përdorimin e sallave të studimit, duke reflektuar efektivitetin e pasurimit të burimeve dhe nevojat për tituj të rinj në mbështetje të programit të studimit.			
Konkluzione	Biblioteka e WBU ofron një gamë të gjerë burimesh fizike dhe dixhitale, të përshtatura me kurrikulën dhe nevojat e studentëve dhe stafit akademik. Përmes anëtarësimeve në platformat <i>online</i> (JSTOR dhe Research4Life), ofronit të literaturës në gjuhën e programit dhe mundësimin të huazimit sipas rregullores përkatëse, biblioteka garanton qasje të barabartë, të plotë dhe funksionale në burimet e saj. <i>GVJ rekomandon rishikimin e syllabuseve dhe përditësimin e temave në përputhje me literaturë/apo me versione të tyre të përditësuara të pesë viteve të fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim mbahet nga njësitë administrative, si zyrat e Sekretarisë Mësimore dhe Burimeve Njerëzore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. WBU ka në përdorim platformën SMART WBU, ku ka digjitalizuar dokumentacionin sipas njësive përkatëse. Të dhënat e studentëve ruhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me Statutin e WBU dhe me rregulloret mbi të dhënat, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. [evidenca 1.16.]; [evidenca 3.33.];
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Referuar rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave personale etj, konstatohet se është ngritur sistemi i brendshëm i menaxhimit [evidenca 3.31]. Ky sistem administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, si dhe personelit ndihmës akademik.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se aksesin në sistemin e WBU mundësohet nëpërmjet faqes web, ku mundësohet hyrja e dedikuar e studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Nëpërmjet këtij sistemi: - Studentët kanë akses në të dhënat e tyre akademike, notat, mungesat, si dhe të dhënat financiare; - Stafi akademik ka akses për të parë rezultatet akademike të studentëve me qëllim që të ndjekë ecurinë e tyre dhe për të bërë këshillimin e dubur në lidhje me lëndët që studenti duhet të ndjekë në semestrin pasardhës; https://WBU.edu.al/en/program/master-of-science-in-hospital-management ; [evidenca 2.27.]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar	Referuar RVB, sistemi i menaxhimit të WBU ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë komunikim interaktiv

platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Personeli i WBU-së dhe studentët janë të pajisur me adresa zyrtare të komunikimit të brendshëm elektronik nëpërmjet platformës "SMART-WBU" për komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Referuar RVB, sistemi i menaxhimit WBU mundëson monitorimin e aktivitetit akademik administrativ të institucionit. Sistemi mundëson nxjerrjen e listave të notave të studentëve, listat e notave në bazë lënde, listë-prezencat për lëndët respektive, etj. Raportimet individuale të personelit akademik dhe administrativ bëhen në mënyrë periodike pranë departamenteve përkatëse dhe organeve dhe autoriteteve të universitetit. Ky aktivitet mundësohet nga platforma "SMART-WBU".			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të dhënat për programin Master i Shkencave në "Nanoteknologji" publikohen në faqen zyrtare të WBU. Në këtë faqe gjendet informacion i përditësuar edhe për personelin akademik, zyrat e shërbimeve studentore, kërkimin shkencor dhe projektet, aktivitete të ndryshme të organizuara në WBU, dokumentacionin e funksionimit të institucionit, vendimet e brendshme etj. Informacioni në faqen e internetit, ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze.			
Konkluzione	<i>WBU ka vënë në përdorim platformën SMART WBU, nëpërmjet të cilës administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, lehtëson komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit, duke rritur cilësinë e mësimnxënies, si dhe shërben edhe për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</i> <i>Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe administrativ çdo vit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar raportit vjetor të universitetit konstatohet se hartohet raporti financiar i kostove për programin e studimit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve [evidenca 4.37]. Për sa më sipër garantohej siguri për ciklet e plotë të studimit.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Referuar statutit të WBU [evidenca 1], rregullores të zyrës të prokurimeve dhe shërbimeve administrative [evidenca 4.38], rregullores së bordit të administrimit [evidenca 4.39] etj, konstatohet që plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase etj.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Referuar RVB-së konstatohet se institucioni kryen në mënyrë periodike auditime, për të vlerësuar dhe dokumentuar efektivitetin e financimit dhe të burimeve financiare. Përveç kësaj, institucioni i nënshtrohet edhe auditimeve të jashtme në përputhje me legjislacionin aktual. [evidenca 4.38]




Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Raportimi mbi buxhetin bëhet në nivel Fakulteti, ku njësia kryesore ka përfaqësuesit e saj. Sipas Rregullores për organizimin administrativ të WBU, administratori i fakultetit është përgjegjës për operacionet financiare dhe administrative të fakultetit. Ai menaxhon detyrat financiare dhe administrative, mbikëqyr aktivitetet financiare, përmbush kërkesat e dekanit, adreson nevojat akademike dhe administrative, si dhe mbikëqyr konferencat dhe seminarët për programet e studimit të ofruara nga fakulteti. [evidenca 1.16]			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar tek statuti dhe rregullorja e WBU [evidencat 1. dhe 2.], si dhe rregullorja e bordit të administrimit [evidenca 4.39] garantohet qëndrueshmëria financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon projekte të ndryshme [evidenca 1.16].			
Konkluzione	Veprimtaria vjetore akademike dhe financiare e WBU përmbledhet në një raport vjetor që miratohet nga instancat drejtuese të institucionit. Raportet financiare përgatiten çdo vit. Buxheti përgatitet bazuar në projekte dhe kërkesat financiare të njësive përbërëse. WBU kryen auditime të brendshme dhe të jashtme për të vlerësuar efektivitetin e financimit dhe burimeve financiare. Administratori i fakultetit menaxhon detyrat financiare dhe administrative në nivel njësie kryesore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

4

[Signature]

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e WBU specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kriteret e pranimit për ciklin e dytë, përfshijnë aftësinë në gjuhën angleze për programin Master i Shkencave dhe kërkojnë miratimin e Senatit Akademik, me shpallje publike nga njësia kryesore. [evidencën 5.1]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni i ka të përcaktuara kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e të gjithë programeve të studimit, që ai ofron. Gjatë ciklit akademik, aktet rregullatore të institucionit kanë parashikime që mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë studentët e programit të studimit. Respektimi me rigorozitet i këtyre rregullimeve nga strukturat e institucionit dhe personeli akademik, mundëson respektimin e parimit të barazisë dhe garantimit të të drejtave në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët që ndjekin këtë program. Për studentët e huaj, WBU ka procedura me kritere specifike pranimi. Në programin e studimit MSc në Nanoteknologji, në vitin akademik 2024- 2025, vazhdon studimet 1 studente e huaj. [evidencën 5.2]; [evidencën 5.10]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve.	Aktet rregullatore të institucionit kanë përcaktuar kriteret e pranimit në varësi të ciklit të studimit. Referuar <i>nenit 12</i> të Rregullores së programeve të ciklit të dytë, kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që: - kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë;

Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	- si dhe plotësojnë standardet akademike të kriterëve të pranimit të WBU; Këto kriterë miratohen nga Senati Akademik. Të gjithë aplikantët që pranohen në programin e studimit Master i Shkencave, duhet të jenë njohës të mirë të gjuhës angleze vërtetuar me certifikata ndërkombëtare. Kandidatët që kanë kryer studimet universitare në gjuhën angleze përjashtohen nga kërkesa për njohjen e gjuhës angleze. <i>[evidencën 1.1]; [evidencën 2.1]</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	WBU ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore, përfshirë Statutin, rregulloret e brendshme si dhe akte të tjera normative, të cilat disiplinojnë të gjitha aspektet e jetës universitare. Në përmbajtjen e tyre ka parashikime mbi procedura dhe rregullime që i referohen mbarëvajtjes së këtij programi studimi. Studentët informohen mbi procedurat e vlerësimit që në javën e parë të ciklit të studimeve, nëpërmjet Sesioneve të Orientimit Akademik dhe gjatë orës së parë të mësimi për çdo lëndë gjatë prezantimit të syllabusit. Për çdo problem specifik, studentët mund të kërkojnë informacion nga këshilltari akademik, koordinatori i programit dhe përgjegjësi i departamentit. <i>[evidencën 1.1]; [evidencën 2.1]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në fillim të vitit akademik, WBU informon studentët në lidhje me kërkesat e kriteret të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta janë përcaktuar në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" <i>[evidenca 4.]</i> të hartuara nga Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Referuar kuotave të parashikuara për studentët <i>[evidenca 5.5]</i>, konstantohet që WBU harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta. Ky proces bëhet përmes kuotave të veçanta dhe mbajtjes së seminareve për ndërgjegjësimin e studentëve. Në godinën kryesore të institucionit ka infrastrukturë të veçantë për përdorimin e mjeteve ndihmëse për këtë kategori sociale të veçantë dhe shfrytëzimin e hapësirave të veçanta (ashensori, nyjet sanitare).

Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ referuar rregullores themelore (Nenet 54-55) [evidenca 2.] konstaton se janë përcaktuar kriteret për pranimin e kandidatëve nga shtete të tjera. Në dispozicion të studentëve të huaj janë dy zyra të posaçme, Zyra e Marketingut dhe Pranimeve, si dhe Zyra e Orientimit dhe Mbështetjes së Studentëve. Studentët e huaj kanë të gjitha informacionet akademike, ekonomike dhe ato të jetesës në Shqipëri. [evidenca 2]; [evidenca 5.1]			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	WBU publikon dhe përditëson periodikisht të dhënat në lidhje me tarifat e studimit, kategoritë e bursave dhe bursat nga institucionet partnere. Institucioni ofron mbështetje për studentët e kategorive të ndryshme përmes bursave të ekselencës, bursave institucionale, si dhe bursave të studimit për maturanët që vijnë nga zona të veçanta të vendit. WBU, po ashtu, harton politika të ndihmës për studentët me kushte të vështira. [evidenca 1.16]			
Konkluzione	Politikat, kriteret dhe procedurat e pranimin të studentëve janë të parashikuara në dokumenta të posaçme, si dhe janë të publikuara edhe online. Këto dokumenta përmbajnë informacion të plotë lidhur me informimin për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në WBU. WBU ka hartuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në programin e studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. WBU ka formuluar dhe zbaton politikë të akordimit të bursave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e	Në rregulloren themelore të Institucionit [Rregullore Institucionale, Neni 90] jepet informacioni i nevojshëm mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, si më poshtë:

procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	• Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 30 kredite të vitit të parë. • Studenti i vitit të fundit që në përfundim të provimeve të vitit rezulton me kredite të pashlyera, në rastet kur ka përmbushur detyrimin e frekuentimit të lëndëve, ka të drejtë t'i likujdojë ato në një periudhë të caktuar nga dekanati përpara sezonit të diplomimit. Në rast të kundërt studenti detyrohet të shlyejë detyrimin e frekuentimit. • Studenti që shlyen të gjitha detyrimet akademike ka të drejtë të hyjë në mbrojtjen e diplomës. Në rast të kundërt, i lind e drejta e shlyerjes së tyre në semestrin pasardhës, ndërsa diplomimi bëhet pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren themelore të Institucionit <i>[Rregullore Institucionale, Neni 68]</i> jepen kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme: • Universiteti “Western Balkans”, mund të njohë si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme dhe që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit. • Në rastin e transferimit të studimeve komisioni ad hoc i ngritur nga departamenti respektiv mund të njohë deri në 60 (gjashtëdhjetë) kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 (dyzet) kredite për programet e studimit të ciklit të dytë. Ndërsa në rastin kur kemi të bëjmë me njohje të lëndëve dhe krediteve të fituara më parë numri i krediteve, ECTS që do të njihen përcaktohen nga komisioni ad hoc i ngritur nga departamenti respektiv. Komisioni i ngritur nga njësia bazë vendos për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve vihen në dispozicion të studentëve në rregulloren themelore të institucionit <i>[Rregullore Institucionale, Kreu XII]</i>, rregulloren e programeve të studimit të ciklit të dytë <i>[Evidencë 2.1, Neni 20]</i>, syllabuset e lëndëve <i>[Syllabuse]</i> dhe ju bëhen të ditura studentëve gjatë javës së parë të semestrit, në orët e para të mësimi.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës përcaktohen në rregulloren e programeve të ciklit të dytë [Evidencë 2.1, Neni 32]: • Studenti, i cili ka kaluar me sukses në të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të fakultetit, nuk ka asnjë notë të vlerësuar me (D ose F) dhe ka përfunduar të gjitha punimet e parashikuara në këtë rregullore, pajiset me diplomën e përshtatshme të programit të studimit. • Studentëve, të cilët në prag të diplomimit kanë jo më shumë se tre lëndë (D ose F), u jepet e drejta të përdorin vetëm një herë të drejtën e provimit shtesë për jo më shumë se tre lëndë në të cilat kanë marrë (D ose F) në përfundim të atij semestri. Në këtë rast nota e marrë në provim zëvendëson notën e marrë më parë. • Studentët të cilëve u njihet e drejta e diplomimit, në mënyrë që të tërheqin diplomën duhet të paraqesin në njësitë kompetente dokumentet me të cilat tregojnë se nuk kanë detyrime ndaj institucionit.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në WBU funksionon Zyra e Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimi të Studentëve, si njësi përgjegjëse për informimin e vazhduar të kandidatëve për studentë mbi programin e studimit. Nën kujdesin e kësaj zyre mundësohet pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme promovuese si panairi “Work and study”, organizmi i ditëve informuese brenda institucionit [Evidencë 4.35], përgatitja dhe shpërndarja e guidës së Universitetit me programet e ofruara [Evidencë 4.36], promovimi i programeve të studimit në rrjetet sociale etj.			
Konkluzione	<i>Në rregulloret institucionale të WBU përcaktohen qartë kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, të njohjes së kualifikimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të realizimit të diplomës, duke garantuar transparencë dhe standarde të barabarta për të gjithë studentët.</i> <i>Institucioni siguron informimin e vazhdueshëm të kandidatëve dhe studentëve përmes Zyrës së Komunikimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Pranimi të Studentëve, e cila kujdeset për organizimin e aktiviteteve promovuese, ditëve informuese, shpërndarjen e guidës së universitetit dhe prezantimin e programeve të studimit në rrjetet sociale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë javës orientuese, studentët e rinj informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit bazuar në aktet rregullatore të institucionit: statutin e Universitetit [<i>Statuti</i>], rregulloren themelore të Institucionit [<i>Rregullore Institucionale</i>], rregulloren e Fakultetit [<i>Evidencë 1.1</i>], rregulloren e programeve të ciklit të dytë [<i>Evidencë 2.1</i>].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentëve të rinj, gjatë javës së parë të vitit akademik, ju vihet në dispozicion guida studentore [<i>Evidencë 4.36</i>], e cila përmban informacion të hollësishëm mbi programet e studimit dhe universitetin. Informacione mbi programet e studimit vihen në dispozicion edhe në faqen web të institucionit. Studentët kanë akses në programin mësimor dhe syllabuset e lëndëve edhe përmes platformës Smart WBU.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	WBU mbështet integrimin profesional të studentëve përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës, e cila në bashkëpunim me institucione publike e private, kombëtare dhe ndërkombëtare, orienton studentët drejt tregut të punës. Kjo zyrë ofron këshillim individual dhe në grup, trajnime për përgatitjen e CV-së dhe letrës së motivimit, zhvillimin e intervistave për punë, si dhe aktivitete të dedikuara si Career Workshop dhe Career Fair. Gjithashtu, studentëve u krijohen mundësi praktike dhe punësimi përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, përfshirë nismën rajonale EPIC.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe	Studentët informohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhduar përmes këshilltarit akademik, koordinatorit të programit të studimit dhe përgjegjësit të departamentit, mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, si dhe infrastrukturën dhe shërbimet në dispozicion. Informacione vihen gjithashtu në dispozicion edhe në guidën e studentit, platformën Smart WBU dhe faqen web të institucionit.

shërbimet në funksion të realizimit të tij.									
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacion i detajuar mbi programin e studimit vihet në dispozicion në platformë Smart WBU, në të cilin studentët kanë lehtësisht akses përmes llogarive personale edhe në distancë.								
Konkluzione	<i>WBU siguron informimin dhe orientimin e plotë të studentëve që në fillim të vitit akademik gjatë javës orientuese, përmes guidës studentore, faqes zyrtare të internetit dhe platformës Smart WBU, ku ofrohen të gjitha informacionet mbi programet e studimit, rregulloret dhe syllabuset.</i> <i>Studentët mbështeten vazhdimisht nga këshilltari akademik, koordinatori i programit të studimit dhe përgjegjësi i departamentit, si dhe përfitojnë shërbime për integrimin profesional nga Zyra e Planifikimit të Karrierës, e cila ofron këshillim individual e në grup, trajnime praktike dhe mundësi punësimi në bashkëpunim me institucione publike e private, përfshirë nismën rajonale EPIC.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	WBU nëpërmjet strukturave të tij, disponon dhe administron statistika vjetore mbi numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi. Administrimi i të dhënave në regjistrat përkatës realizohet në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera nënligjore. Përgjegjëse për administrimin e të dhënave është Sekretaria Mësimore, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe aktet rregullatore të institucionit.

	Për këtë program studimi akoma nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	WBU disponon dhe administron statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Institucioni administron gjithashtu edhe të dhëna lidhur me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit për çdo vit akademik, tërheqjet nga programi apo largimet para përfundimit të programit, si dhe transferimet nga institucione të tjera brenda ose jashtë vendit. Të gjitha të dhënat që lidhen me ecurinë akademike të studentëve që nga momenti i regjistrimit, e deri në përfundimin me sukses të ciklit akademik, administrohen pranë Sekretarisë Mësimore. Nga vëzhgimi i GVJ pranë Sekretarisë Mësimore u konstatua administrimi në mënyrë të rregullt i të dhënave të studentëve për të gjithë ciklin akademik. Referuar të dhënave të marra në sekretarinë mësimore gjatë vizitës në institucion numri i studentëve në këtë program studimi është si më poshtë vijon: Viti akademik 2023-2024 7 studentë; Viti akademik 2024-2025 4 studentë.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e dokumentacionit të studentëve të këtij programi studimi është Sekretaria Mësimore. Me qëllim mirëmenxhimit të të dhënave, një pjesë e të dhënave që u referohen studentëve administrohen jo vetëm në format dokumentar, por edhe elektronik. Nëpërmjet platformës SMART WBU, institucioni disponon dixhitalizimin e dokumentacionit sipas njësive prodhuese. [Evidenca Nr.3.33]
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet	Strukturat përgjegjëse të WBU ruajnë dhe administrojnë informacionin mbi të dhënat e studentëve të këtij programi studimi. Informacioni shkresor administrohet në përputhje me rregullat e administrimit dhe arkivimit të informacionit. Informacion mbi të dhënat e studentëve, përveç Sekretarisë Mësimore, disponojnë edhe një sërë strukturash të tjera si departamentet, dekanati, rektorati etj. Aktet e brendshme të institucionit rregullojnë edhe marrëdhëniet hierarkike brenda strukturave, duke përcaktuar për strukturat eprorë kompetenca të vlerësimit dhe kontrollit periodik të informacionit. WBU kryen auditime të brendshme për të siguruar përputhshmërinë dhe zbatimin e akteve ligjore

me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	dhe akteve të brendshme të njësive përgjegjëse për menaxhimin. [Evidenca Nr.4.7]								
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Pranë Sekretarisë Mësimore administrohen dosjet e studentëve ku pasqyrohet edhe informacion mbi notën mesatare të maturës shtetërore. Bazuar në këto të dhëna, institucioni harton dhe administron statistika që i referohen cilësisë së studentëve në hyrje, në fazën e regjistrimit në këtë program studimi, si dhe në dalje në përfundim të ciklit akademik. Referuar dokumentacionit cilësia në hyrje për këtë program stdumi në dy vitet akademike është si më poshtë: 2023 – 2024 mesatarja në hyrje 9.23; 2024 – 2025 mesatarja në hyrje 7.27; [Evidenca Nr.5.14]								
Konkluzione	<i>WBU nëpërmjet strukturave përgjegjëse, disponon dhe administron informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me studentët që ndjekin këtë program studimi.</i> <i>Administrimi dhe menaxhimi i të dhënave realizohet në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë, si dhe aktet e tjera nënligjore.</i> <i>Institucioni harton dhe administron statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, deri në diplomimin e tyre, si dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve	Referuar rregullores themelore të WBU (neni 110) parashikohet përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore.

di

Gaut 27

dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Senati Akademik i WBU-së ka në përbërjen e tij 2 studentë, të cilët përfaqësojnë Këshillin Studentor. Studentët janë të përfaqësuar edhe në komisionet e përhershme në institucion, përfshirë edhe NjSBC. Përmes Zyrës së Koordinimit të Klubeve Studentore dhe Dekanatit të Studentëve, mundësohet organizimi i klubeve studentore në fusha të ndryshme akademike, sociale, kulturore, artistike dhe sportive. [evidenca 2.]; [Evidenca Nr.5.16];[Evidenca Nr.5.18]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Këshilli Studentor i WBU është një organ kyç në përfaqësimin e interesave të studentëve në institucion. Zgjedhja e këshillit bëhet me parime demokratike dhe synimi i tij është përfaqësimi studentor pa dallim ideje, feje, gjinie, race apo origjine. Këshilli nuk merret me aktivitet politik apo ekonomik dhe nuk mund të përfshihet në struktura të tjera jashtë institucionit. Bazuar në Rregulloren mbi Organizimin Administrativ të WBU, kryetari i këshillit studentor përfaqëson studentët në organet vendimmarrëse të WBU. Studentët shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm për studentët. [Evidenca 5.20]. [Evidenca Nr.1.16]
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Në kuadrin e të drejtave të tyre, Statuti ka sanksionuar të drejtën e studentëve të shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e personelit akademik. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në kuadrin e kompetencave të saj në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo lëndë të programit të studimit. Këto pyetësore shërbejnë më tej në procesin e vlerësimit të cilësisë si dhe në vendimmarrjen e Departamentit mbi aspekte që lidhen me programin e studimit. [Evidenca Nr.6.7]
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit,	Rregullat dhe detyrimet e provimeve, si dhe ankimimi i rezultateve, janë të përcaktuara qartë nga institucioni përmes rregulloreve institucionale. Në javën e parë të çdo semestri, pedagogët publikojnë sistemin e vlerësimit për lëndët përkatëse. Rezultatet e provimeve ju dorëzohen organeve administrative të departamentit brenda afatit të caktuar. Nëse studenti nuk është i kënaqur me rezultatin, ai mund të ankohet me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. Ankimimi

rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	shqyrtohet nga një komision i ngritur me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës brenda tre ditësh. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit brenda 15 ditësh nga paraqitja e kërkesës për rishikim. [Evidenca 2.1]			
Konkluzione	<i>Studentët në WBU marrin pjesë në komisionet e përhershme dhe NjSBC. Zyra e Koordinimit të Klubeve Studentore dhe Dekanati i Studentëve mbështesin organizimin e klubeve studentore në fusha të ndryshme. Studentët vlerësojnë periodikisht performancën e pedagogëve dhe përmbajtjen e lëndëve. Rregullat për provimet dhe ankimimet janë të qarta për studentët.</i> <i>Në WBU vihet re se përfshihen dhe angazhohen studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Statuti i Universitet dhe aktet e brendshme rregullatore kanë parashikuar struktura dhe procedura në funksion të informimit të studentëve. Struktura të tilla janë Sekretaria Mësimore, dhe Departamenti si njësi përgjegjëse për administrimin e procesit akademik që i referohet këtij program studimi. Gjithashtu WBU ka një sistem të menaxhimit që bazohet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Ky menaxhim përcaktohet në Statutin e WBU, Rregulloren Themelore dhe Rregulloren mbi organizimin administrativ. Universiteti ruan edhe kopjet fizike dhe elektronike të dokumentacionit të studentëve sipas dispozitave ligjore. Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës është përgjegjëse për arkivimin dhe administrimin e dokumenteve të krijuara në institucion.

	Sekretaria Mësimore monitoron dhe arkivon çdo regjistrim dhe informacion lidhur me studentët. Platforma SMART WBU dixhitalizon dokumentacionin dhe siguron trajtimin e të dhënave sipas kërkesave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>[Evidenca 1.16] Rregullorja Themelore e Universitetit Western Balkans;</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Departamenti i Bioshkencave dhe Inxhinierisë, që është edhe njësi bazë që mbulon këtë program studimi është përgjegjës për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve nëpërmjet njësive të sipërpërmendura, por edhe stafit të saj akademik. Koordinator i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Njësia përgjegjëse për këtë program studimi administron rrjetet sociale për të krijuar një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, duke ofruar në këtë mënyrë informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit. Studentët marrin informacion edhe nëpërmjet aksesit në sistemin e menaxhimit të informacionit dhe përdorimit të platformës SMART WBU. <i>[Evidencat 3.31, 1.16]. [Evidenca Nr.2.5]</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstaton se shërbimi i këshillimit të karrierës për studentët e WBU ofrohet nga Zyra e Planifikimit të Karrierës. Specialistët e Zyrës, këshillojnë studentët për të gjitha hallkat në përgatitjen për tregun e punës. Nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme si: trajnime me fokus përgatitjen për intervistë pune, panairin e punës, leksione të hapura (me të ftuar) me përfaqësues nga bota akademike dhe e biznesit, përdorimin e faqes web të WBU, etj, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes aktive, të promovimit të studentëve, si dhe rritjen e mundësive të punësimit të tyre. <i>[evidenca 1.16] [evidenca 5.12]</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët	WBU ka edhe Zyrën e të Diplomuarve që bën gjurmimin e të diplomuarve në tregun e punës, krijimin e një rrjeti të gjerë të

pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	komunikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme me ta. Kjo zyre përcjell studentët pas diplomimit, mbledh dhe analizon të dhënat mbi punësimin e studentëve dhe informon studentët dhe organet drejtuese. <i>[evidenca 1.16]</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore e Fakultetit; koordinatori i programit të studimit; si dhe Platforma SMART WBU.</i> <i>Specialistët e Zyrës së Planifikimit të Karrierës ju ofrojnë studentëve informacion dhe këshillim për procesin mësimor, praktika profesionale, si dhe orientim në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ nisur nga DVV dhe RVB konstaton që institucioni nuk ka vënë në dispozicion në nivel institucional një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	WBU ka ngritur disa mekanizma përmes të cilëve monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik: - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga studentët [<i>Evidencë 3.5</i>]; - Formulari i vlerësimit të lëndës nga studentët [<i>Evidencë 3.6</i>]; - Formulari i vlerësimit të personelit akademik nga kolegët [<i>Evidencë 3.7</i>]; - Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik [<i>Evidencë 3.8</i>].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në fund të çdo semestri, studentët kanë mundësinë të shprehin mendimin e tyre mbi lëndët dhe pedagogët përmes pyetësorëve të hartuar nga NjSBC [<i>Evidencë 3.5</i>; <i>Evidencë 3.6</i>]. Rezultatet e këtyre pyetësorëve përpunohen dhe pasqyrohen në raporte, të cilat i vihen në dispozicion organeve drejtuese të institucionit, me qëllim ndërmarrjen e masave të nevojshme dhe reflektimin për përmirësimin e procesit mësimor. Studentët përmes pyetësorit mund të shprehin shqetësimet e tyre mbi zhvillimin e lëndës nga personeli akademik.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Raporti përmbledhës i vlerësimit të mësimdhënies nga studentët [<i>Evidencë 3.9</i>] ju vihet në dispozicion organeve drejtuese dhe bëhet publike në faqen web të Institucionit dedikuar NjSBC (https://iqau.wbu.edu.al/) duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e individëve. Në raporte përdoren shënime të anonimizuara si “profesor 1”, “profesor 2”, në vend të emrave realë, në mënyrë që informacioni të jetë transparent pa cënuar identitetin e personelit akademik.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në Rregulloren mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit [<i>Evidencë 4.11</i>, <i>Neni 17</i>], institucioni parashikon promovimin e stafit akademik nisur nga performanca e lartë akademike. Në këtë kuadër, Institucioni ka hartuar udhëzime që nxisin dhe rregullojnë procedurat për mbështetjen e publikimeve shkencore, pjesëmarrjen në konferenca dhe përfshirjen në aktivitete kërkimore shkencore të stafit akademik me kohë të plotë [<i>Evidencë 2.19</i>].

	Këto udhëzime përfshijnë një procedurë efikase vlerësimi dhe financimi për publikime në revista të indeksuara [<i>Evidencë 2.20</i>] dhe për pjesëmarrjen në konferenca [<i>Evidencë 2.22</i>].			
Konkluzione	<i>WBU ka ngritur mekanizma të qartë për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse të stafit akademik përmes formularëve të vlerësimit nga studentët, kolegët dhe vetëvlerësimet, ndërkohë që rezultatet përpunohen dhe raportohen rregullisht tek organet drejtuese dhe publikohen duke respektuar privatësinë. Studentëve u ofrohet mundësia të shprehin shqetësimet dhe sugjerimet e tyre mbi zhvillimin e lëndëve, duke kontribuar në përmirësimin e procesit mësimor.</i> <i>Institucioni ka parashikuar në rregullore promovimin e stafit mbi bazën e performancës akademike dhe ka hartuar udhëzime të posaçme për nxitjen e publikimeve shkencore, pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete kërkimore, duke siguruar mbështetje financiare dhe procedura transparente për zhvillimin profesional të stafit.</i> <i>GVJ rekomandon hartimin dhe vënien në dispozicion të udhëzuesve mbi metodat inovative të mësimdhënies, të përshtatura me programet e studimit të ofruara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sigurimi i cilësisë në WBU garantohet përmes: - Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit [<i>Statuti, Neni 35; Evidencë 3.10</i>]; - Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) [<i>Statuti, Seksioni VII; Evidencë 3.12</i>]. Në kuadër të funksionimit korrekt të tyre janë hartuar: - Rregullorja e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit [<i>Evidencë 3.11</i>];



	• Rregullorja e NjSBC [<i>Evidencë 3.13</i>]; • Paketa e instrumentave të sigurimit të brendshëm të cilësisë [<i>Evidencë 2.7</i>];
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sistemi i brendshëm i cilësisë në WBU monitorohet dhe garantohet nga NjSBC dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit. Këto struktura bashkëpunojnë ngushtë me strukturat e tjera të institucionit për realizimin e misionit të tyre. Studentët kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes dhënies së mendimeve të tyre, të mbledhura me anë të pyetësorëve të zhvilluar në fund të çdo semestri mbi lëndët dhe pedagogët [<i>Evidencë 3.5; Evidencë 3.6</i>]. Në kuadër të hartimit të kurrikulave të reja Institucioni angazhon edhe ekspertë të jashtëm [<i>Evidencë 6.6</i>]. Një vend të rëndësishëm në hartimin e politikave dhe strategjive të NjSBC ka luajtur edhe pjesëmarrja e WBU në projektin Erasmus+ QA-SURE [<i>Evidencë 6.5</i>].
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	NjSBC ka përcaktuar paketën e instrumentave të sigurimit të brendshëm të cilësisë [<i>Evidencë 2.7</i>] përmes të cilëve monitoron dhe analizon në mënyrë periodike cilësinë në Institucion. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes akreditimit të programeve të studimit pranë ASCAL. Ky program studimi është në procesin e parë të vlerësimit të tij.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë,	Institucioni parashikon promovimin e stafit akademik mbi bazën e performancës së lartë [<i>Evidencë 4.11, Neni 17</i>] dhe ka miratuar udhëzime që mbështesin publikimet shkencore, pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitetet kërkimore, përmes procedurave të qarta vlerësimi dhe financimi [<i>Evidencë 2.19; Evidencë 2.20; Evidencë 2.22</i>].

institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.				
Konkluzione	<i>Sigurimi i cilësisë në WBU mbështetet në struktura të dedikuara si Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat funksionojnë mbi bazën e rregulloreve përkatëse dhe paketës së instrumenteve të miratuara.</i> <i>Këto struktura monitorojnë dhe analizojnë periodikisht cilësinë në bashkëpunim me organet e tjera institucionale, duke përfshirë studentët përmes pyetësorëve dhe ekspertët e jashtëm në hartimin e kurrikulave të reja. Institucioni ka përfituar gjithashtu nga pjesëmarrja në projektin Erasmus+ QA-SURE për forcimin e politikave të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	Institucioni në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik dhe lëndët e zhvilluara [<i>Evidencë 3.5; Evidencë 3.6</i>]. Raporti përmbledhës i vlerësimit të mësimdhënies nga studentët [<i>Evidencë 3.9</i>] ju vihet në dispozicion organeve drejtuese dhe bëhet publike në faqen web të Institucionit dedikuar NjSBC (https://iqau.wbu.edu.al/) duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e individëve. NjSBC, së bashku me njësinë kryesore, njësinë bazë dhe strukturat drejtuese akademike dhe administrative të institucionit, kryejnë identifikimin e arritjeve dhe mangësive, evidentimin e praktikave më të mira dhe përgatisin planin e masave për përmirësim.

Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raporti përmbledhës i vlerësimit të mësimdhënies nga studentët [<i>Evidencë 3.9</i>] jep të dhënat e pyetësorëve të studentëve për çdo program studimi të çdo fakulteti. Në të paraqitet edhe një krahasim i performancës së stafit akademik midis fakulteteve të ndryshme dhe në nivel institucioni. Raporti mbyllet me konkluzionet e NjSBC për gjetjet nisur nga analiza e rezultateve. Raporti me gjetjet e tij bëhet i disponueshëm për diskutim në strukturat e ndryshme të Institucionit.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimi, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [<i>Evidencë 3.5</i> ; <i>Evidencë 3.6</i>].
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të	Në paketën e instrumentave të sigurimit të brendshëm të cilësisë [<i>Evidencë 2.7</i>] përveç pyetësorëve drejtuar studentëve

realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	dhe personelit akademik, janë parashikuar edhe pyetësorë drejtuar studentëve të diplomuar dhe personelit administrativ dhe ndihmës akademik. <i>Në këtë paketë nuk vihet në dispozicion një pyetësor drejtuar punëdhënësve dhe institucioneve me të cilat institucioni bashkëpunon në realizimin e programit të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni monitoron cilësinë e mësimdhënies përmes pyetësorëve periodikë me studentët, rezultatet e të cilëve përpunohen nga NjSBC në raporte përmbledhëse që publikohen në faqen zyrtare duke ruajtur anonimitetin. Këto raporte ofrojnë të dhëna të detajuara për çdo program studimi e fakultet, krahasojnë performancën e stafit akademik dhe shoqërohen me konkluzione, të cilat diskutohen në strukturat përkatëse.</i> <i>Përveç studentëve, instrumentet e sigurimit të cilësisë parashikojnë përfshirjen e të diplomuarve dhe personelit akademik e administrative.</i> <i>GVJ rekomandon hartimin e një pyetësori drejtuar punëdhënësve dhe institucioneve me të cilat institucioni bashkëpunon në realizimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë, institucioni parashikon përfshirjen, si në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe të tërthortë të studentëve, personelit akademik, administrativ dhe ndihmës akademik, si dhe të ekspertëve të jashtëm, në mënyrë të veçantë në procesin e hartimit të kurrikulave të reja [Evidencë 6.6].
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra të qarta për strukturat e tij të brendshme të angazhuar në sigurimin e cilësisë. Në Rregulloren e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit [Evidencë 3.11] janë të përcaktuara organizimi i brendshëm, kompetencat, detyrat dhe funksionimi i këtij komisioni, ndërsa në Rregulloren e NjSBC [Evidencë 3.13] përcaktohen organizimi dhe funksionimi i njësisë. Këto dokumente garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të detyrave nga njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të përfshira në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Stafi akademik dhe ai administrativ vlerësojnë institucionin përmes pyetësorëve të dedikuar pjesë e paketës së instrumentave të sigurimit të brendshëm të cilësisë [Evidencë 2.7]. Nisur nga të dhënat e mbledhura, NjSBC harton një raport përmbljedhës [Evidencë 6.9]. Njësia bazë dhe kryesore, drejtuesit e tyre, personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, si dhe studentët janë pjesë aktive në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Përfaqësues të tyre hartojnë RVB dhe përgatisin DVV në bashkëpunim me njësitë e ndryshme të Institucionit.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset	Institucioni siguron përfshirjen aktive të personelit akademik dhe studentëve në proceset periodike të vlerësimit, duke respektuar parimet e integritetit akademik dhe barazisë. Të

ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	gjitha procedurat zhvillohen në mënyrë transparente, duke shmangur çdo formë diskriminimi apo trajtimi të pabarabartë. NjSBC përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve 3 (tre) janë përfaqësues të stafit akademik të njësisë kryesore, një për secilin fakultet, 1 (një) përfaqësues i Këshillit të Studentëve dhe 1 (një) ekspert i jashtëm [Evidencë 3.13, Neni 6]. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit përbëhet nga të paktën tetë anëtarë si më poshtë [Evidencë 3.11, Neni 4]: a. Kryetari i komisionit; b. Një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë nga çdo njësi kryesore, me gradë shkencore ‘Doktor/PhD’ dhe pa detyra drejtuese; c. Të paktën dy anëtarë të stafit administrativ; d. Një përfaqësues i të diplomuarve të Universitetit; e. Një ekspert i jashtëm me përvojë të spikatur në fushën e sigurimit të cilësisë; f. Kryetari i Këshillit të Studentëve për çështjet e sigurimit të cilësisë.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ekspertët e jashtëm janë pjesë e NJSBC [Evidencë 3.13, Neni 6] dhe Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit [Evidencë 3.11, Neni 4], si dhe pjesë e grupeve të punës për hartimin e kurrikulave të reja [Evidencë 6.6].			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur një sistem të qartë dhe gjithëpërfshirës për sigurimin e brendshëm të cilësisë, duke përfshirë aktivisht të gjitha njësitë, stafin akademik e administrativ, studentët, të diplomuarit dhe ekspertët e jashtëm, dhe duke garantuar një proces transparent e periodik të vlerësimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në faqen web dedikuar NjSBC (https://iqau.wbu.edu.al/) vihen në dispozicion të të interesuarve informacione në lidhje me politikat, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi. Këto informacione janë transparente dhe publike për të gjithë.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon në faqen e dedikuar web (https://iqau.wbu.edu.al/en/documents-2024-2025) raportet e rezultateve të pyetësorëve drejtuar studentëve, stafit akademik dhe administrativ duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e individëve. Në raporte përdoren shënime të anonimizuara si “profesor 1”, “profesor 2”, në vend të emrave realë, në mënyrë që informacioni të jetë transparent pa cenuar identitetin e personelit akademik.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Mbi bazën e të dhënave të marra nga pyetësorët e parashikuar në paketën e instrumentave të sigurimit të brendshëm të cilësisë [Evidencë 2.7] hartohen raporte, të cilat i përcillen për shqyrtim të mëtejshëm dhe për hartimin e planit të masave organeve drejtuese.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Analizat periodike [https://iqau.wbu.edu.al/en/documents-2024-2025] dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë mundësojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin	Personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët janë pjesë aktive e procesit të vlerësimit. Informimi dhe ndërgjegjësimi i tyre për sigurimin e cilësisë është i

dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	vazhdueshëm, i drejtëpërdrejtë përmes përfshirjes së tyre në vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë (GVB, pyetësorët, plani i masave etj.), dhe e tërthortë përmes përcjelljes së raporteve dhe diskutimit të tyre në takime informuese.			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron transparencë dhe përfshirje të gjerë në proceset e sigurimit të cilësisë, duke publikuar në faqen e dedikuar web informacione, analiza dhe raporte nga pyetësorët, të cilat u përcillen organeve drejtuese për hartimin e planit të masave. Përmes këtyre mekanizmave, ku marrin pjesë aktivisht stafi akademik, ndihmës akademik dhe studentët, garantohet ndërgjegjësim i vazhdueshëm dhe përmirësim i cilësisë së programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Nanoteknologji"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji" është i vetmi i këtij lloji në Shqipëri dhe në rajon, duke ofruar një perspektivë të gjerë zhvillimi në të ardhmen. Programi zhvillohet tërësisht në gjuhën angleze, duke e bërë të aksesueshëm edhe për studentë ndërkombëtarë;
2. Programi ofron një kurrikul ndërdisiplinare që përfshin njohuri të avancuara në fushat kryesore të nanoteknologjisë, me theks të veçantë në aplikimet praktike në industri si farmaceutika, elektronika, energjia e qëndrueshme dhe materialet e avancuara;
3. Mësimdhënia mbështetet nga staf akademik i kualifikuar në universitete prestigjioze ndërkombëtare, disa prej të cilëve janë ekspertë të njohur në nanoteknologji, duke garantuar cilësi të lartë të procesit mësimor dhe mentorim profesional në temat e diplomës;
4. Programi është iniciuar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Njësinë NanoAlb, dhe mbështetet nga partneritete me universitete dhe institute kërkimore ndërkombëtare, duke krijuar mundësi për kërkime të përbashkëta, shkëmbime akademike dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare;
5. Studentët inkurajohen dhe mbështeten të marrin pjesë në projekte kërkimore të financuara, të zhvillojnë teknologji të reja dhe të prezantojnë rezultatet në konferenca dhe publikime shkencore, duke kontribuar në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë;
6. Nëpërmjet partneriteteve me kompani dhe organizata industriale, studentët përfshihen në projekte praktike dhe kryejnë praktika profesionale që rrisin përgatitjen e tyre për tregun e punës. Diplomantët e këtij programi studimi kanë mundësi të gjera punësimi në tregun vendas, rajonal dhe ndërkombëtar;

b. Pika të dobta:

1. Angazhimi në mësimdhënie i personelit akademik të kategorisë asistent lektor (MSc.) (*Standardi IV.1, Kriteri 1*)
2. Numri i ulët i studentëve të regjistruar në këtë program studimipërgjatë viteve akademike 2023-2024 dhe 2024-2025; (*Standardi V.4, Kriteri 2*)

Rekomandime

1. Hartimi dhe ndjekja e politikave për promovimin dhe zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Nanoteknologji", me synim rritjen e interesit dhe numrit të studentëve të regjistruar;
2. Hartimi i raporteve analitike mbi përfitimet e marra nga marrëveshjet kontraktuale, në funksion të realizimit sa më cilësor të programit të studimit;



3. Përcaktimi në syllabuset e lëndëve i ngarkesës jashtë auditorit;
4. Përfshirja e detyrave të kursit me ngarkesën përkatëse në kurrikul;
5. Angazhimi në mësimdhënie i personelit akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik;
6. Hartimi i udhëzuesve mbi metodat inovative të mësimdhënies, të përshtatura me programet e studimit të ofruara;
7. Rishikimi i syllabuseve dhe përditësimi i temave në përputhje me literaturë/apo me versione të tyre të përditësuara të pesë viteve të fundit;
8. Hartimi i një pyetësori drejtuar punëdhënësve dhe institucioneve me të cilat institucioni bashkëpunon në realizimin e programit të studimit;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program *Master of Sciences in "Nanotechnology"*

a. Strengths and affirmations:

1. *Master of Science* in "Nanotechnology" is the only program of its kind in Albania and the region, offering a broad development perspective for the near future. The program is delivered entirely in English, making it accessible to international students;
2. The program offers an interdisciplinary curriculum that provides advanced knowledge in key areas of nanotechnology, with a special focus on practical applications in industries such as pharmaceuticals, electronics, sustainable energy, and advanced materials;
3. Teaching is supported by academic staff trained at prestigious international universities, several of whom are recognized experts in nanotechnology, ensuring a high standard of education and professional mentorship for thesis projects;
4. The program was launched in collaboration with the Academy of Sciences of Albania and the NanoAlb Unit, and is supported by partnerships with internationally renowned universities and research institutes, creating opportunities for joint research, academic exchange, and participation in international projects;
5. Students are encouraged and supported to participate in funded research projects, develop new technologies, and present their findings at conferences and in scientific publications, contributing to the advancement of science and technology;
6. Through partnerships with companies and industrial organizations, students engage in practical projects and internships that enhance their preparation for the labor market. Graduates of this program have strong employment possibilities in the domestic, regional, and international nanotechnology sectors;

b. Weaknesses:

1. Engagement in teaching of academic staff in the category of Assistant Lecturer (MSc.) *(Standard IV.1, Criterion 1)*
2. The low number of students enrolled in this study program during the academic years 2023-2024 and 2024-2025; *(Standard V.4, Criterion 2)*

Recommendation

1. Drafting and implementing policies for the promotion and development of the program of study Master of Science in "Nanotechnology," with the aim of increasing interest and the number of enrolled students;
2. Preparing analytical reports on the benefits derived from contractual agreements, in order to ensure the highest possible quality in the implementation of the study program;
3. Specifying in the course syllabi the workload outside the classroom;
4. Including course assignments with the corresponding workload in the curriculum;
5. Engaging in teaching academic staff holding at least a PhD degree, in accordance with the legal requirements in force for the appropriate level of academic qualification;
6. Developing guidelines on innovative teaching methods, tailored to the study programs offered;
7. Reviewing syllabi and updating topics in line with literature or updated editions published within the last five years;
8. Preparing a questionnaire addressed to employers and institutions with which the university collaborates in the implementation of the study program;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X